

PJESA E PARË ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KUVENDIT

KREU I DISPOZITA PARAPRAKE

Neni 1 Mbledhja e parë e legjislaturës

1. Mbledhja e parë e legjislaturës së Kuvendit, deri në zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, hapet dhe drejtohet nga deputeti më i vjetër në moshë. Në rast mospranimi ose mungese, mbledhja drejtohet nga deputeti që është pas tij më i vjetër në moshë.
2. Tre deputetë, ndër deputetët me moshën më të re, caktohen nga drejtuesi i seancës të kryejnë përkohësisht detyrën e Sekretarisë së Kuvendit deri në zgjedhjen e Byrosë së Kuvendit. Përbërja e Sekretarisë pasqyron, për aq sa është e mundur, përbërjen politike të Kuvendit siç del nga rezultati i zgjedhjeve.
3. Deri në zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit nuk zhvillohet asnjë debat.

Neni 2 Verifikimi i mandateve

Me hapjen e mbledhjes së parë të legjislaturës, drejtuesi i seancës i njofton Kuvendit emrat e personave të zgjedhur dhe kërkon verifikimin e mandateve të tyre.

Neni 3 Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve

1. Kuvendi, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh një Komision të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve të anëtarëve të

Kuvendit. Komisioni përbëhet nga 9 deputetë dhe pasqyron, për aq sa është e mundur, përbërjen politike të Kuvendit siç del nga rezultati i zgjedhjeve. Propozimet për përbërjen dhe Kryesinë e Komisionit bëhen nga përfaqësuesit e grupimeve politike dhe miratohen nga Kuvendi me votim të hapur, me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij.

2. Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve shqyrton dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve dhe brenda 2 ditëve i paraqet Kuvendit në seancë plenare raportin për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit. Në rast se Komisioni vëren paligjshmëri në zgjedhje, i propozon Kuvendit dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese. Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese, e hartuar nga Komisioni, duhet të nënshkruhet nga jo më pak se një e pesta e të gjithë deputetëve brenda 3 ditëve nga leximi i raportit. Nëse në përfundim të kësaj periudhe kërkesa nuk është nënshkruar dhe dërguar në Gjykatën Kushtetuese, deputeti ftohet të kryejë betimin.

Neni 4

Betimi i deputetëve

(ndryshuar pika 2 me vendimin nr. 41/2013)

1. Menjëherë pas verifikimit të mandateve deputetët ftohen të bëjnë betimin.

2. Teksti i betimit është: “Beto hem me nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën si deputet i popullit në Kuvend. Do të përfaqësoj denjësisht popullin, do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve, do të mbroj lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë, do të respektoj dhe do të mbroj të drejtat dhe liritë e shtetasve dhe do të punoj me të gjitha fuqitë e mia për përparimin e Atdheut dhe mirëqenien e popullit tim.”

3. Teksti i betimit lexohet nga drejtuesi i seancës dhe deputetët ftohen, një e nga një, të ngrihen në këmbë dhe të deklarojnë “Beto hem”.

4. Deputetët që mungojnë në seancën kur kryhet betimi, betohen në seancën më të parë në të cilën marrin pjesë.

5. Drejtuesi i seancës, në këshillim me Sekretarinë e Përkohshme, deklaron mbarimin e mandatit të deputetit kur ai nuk pranon të betohet ose i shmanget betimit dhe njofton menjëherë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Deklarimi i mbarimit të mandatit botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

KREU II

KRYETARI I KUVENDIT, BYROJA E KUVENDIT DHE KONFERENCA E KRYETARËVE

Neni 5

Organet drejtuese

Menjëherë pas kryerjes së betimit nga deputetët, procedohet me zgjedhjen e Kryetarit dhe të Byrosë së Kuvendit.

Neni 6

Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit

1. Kandidati për Kryetar të Kuvendit propozohet nga të paktën 15 deputetë. Një deputet nuk mund të mbështesë më shumë se një kandidat. Propozimi bëhet me shkrim, përmban nënshkrimet përkatëse dhe paraqitet në Sekretarinë e Përkohshme të Kuvendit.

2. Kryetari i Kuvendit zgjidhet pa debat dhe me votim të fshehtë, me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar, vijohet me një raund të dytë, ku votohet për dy kandidaturat që kanë marrë më shumë vota.

3. Votimi organizohet publikisht dhe drejtohet nga një komision votimi, i përbërë prej 5 deputetësh, që pasqyron, për aq sa është e mundur, përbërjen politike të Kuvendit. Anëtari më i vjetër në

moshë kryen edhe detyrën e kryetarit të komisionit të votimit dhe shpall rezultatin e votimit.

4. Drejtuesi i seancës fton menjëherë Kryetarin e Kuvendit të zërë vendin e tij.

Neni 7

Kryetari i Kuvendit

(ndryshuar pika 2, 3 dhe 4 me vendimin nr. 41/2013)

1. Kryetari i Kuvendit përfaqëson Kuvendin, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij. Ai kujdeset për zhvillimin e veprimtarisë parlamentare, në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, si dhe për sigurimin e kushteve të nevojshme Kuvendit dhe strukturave të tij.

2. Në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, Kryetari u jep fjalën deputetëve dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, drejton dhe moderon në mënyrë të paanshme debatet, siguron rendin në seancë plenare, cakton radhën e votimeve dhe njofton rezultatin e tyre.

3. Kryetari i Kuvendit, në këshillim me kryetarët e grupeve parlamentare, përcakton listën e anëtarëve dhe të kryesive të delegacioneve të përhershme të Kuvendit pranë organizatave ndërkombëtare. Përbërja e delegacioneve pasqyron, për aq sa është e mundur, përbërjen politike të Kuvendit dhe është në përputhje me rregullat e përfaqësimit në organizatat përkatëse.

Lista e anëtarëve të delegacioneve të përhershme dhe çdo ndryshim i mëvonshëm në to i njoftohen Kuvendit në seancën plenare më të parë. Në rast kundërshtimesh, Kuvendi vendos me votim të hapur.

4. Kryetari i Kuvendit, në bashkëpunim me Kryetarët e grupeve parlamentare dhe Sekretariatit për Marrëdhëniet me Jashtë, cakton delegacionet e përkohshme, që përfaqësojnë Kuvendin në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Neni 8
Byroja e Kuvendit
(Ndryshuar pika 2 me vendimin nr. 21, datë 04.03.2010 dhe
pika 1 me vendimin 41/2013)

1. Byroja e Kuvendit ndjek dhe vendos për çështjet administrative, si dhe funksionimin e brendshëm të Kuvendit dhe të organeve të tij.
2. Byroja e Kuvendit përbëhet nga Kryetari i Kuvendit, zëvendëskryetarët, 2 sekretarë për buxhetin e 4 sekretarë dhe drejtohet nga Kryetari i Kuvendit. Përbërja e Byrosë së Kuvendit pasqyron, për aq sa është e mundur, përbërjen politike të Kuvendit. Nuk mund të zgjidhet më shumë se një sekretar nga i njëjti grup parlamentar. Një Zëvendëskryetar duhet t'i përkasë partisë më të madhe të opozitës parlamentare.
3. Kryetari i Kuvendit këshillohet me kryetarët e grupeve parlamentare për përbërjen e Byrosë së Kuvendit.
4. Përbërja e Byrosë së Kuvendit përcaktohet me mirëkuptim në mbledhjen e Kryetarit të Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare. Kryetari ia propozon atë Kuvendit për votim në seancë plenare, i cili vendos me votim të hapur.

Neni 9
Zëvendëskryetarët e Kuvendit

Zëvendëskryetarët bashkëpunojnë me Kryetarin e Kuvendit për realizimin e detyrave të Kryetarit; ata thirren për këshillim nga Kryetari sa herë shihet e nevojshme. Në rast se Kryetari mungon ose është në pamundësi të kryejë detyrat e tij, ai autorizon një nga zëvendëskryetarët për kryerjen e tyre. Në mungesë të autorizimit, ai zëvendësohet nga Zëvendëskryetari i Kuvendit që i përket shumicës parlamentare.

Neni 10
Sekretariatet e Kuvendit
(ndryshuar me vendimin nr. 41/2013)

1. Sekretariatet e Kuvendit, që funksionojnë pranë Byrosë së Kuvendit, janë: Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit, Sekretariati për Procedurat dhe Votimet, Sekretariati për Statusin e Deputetit, Sekretariati për Kërkimin Shkencor, Biblotekën dhe Botimet Parlamentare, si dhe Sekretariati për Marrëdhëniet me Jashtë të Kuvendit.
2. Sekretariatet përbëhen nga 3 deputetë secili, ndërsa Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit nga 5 deputetë. Përbërja e tyre miratohet nga Kuvendi me votim të hapur me propozim të Kryetarit të Kuvendit, pas këshillimeve me kryetarët e grupeve parlamentare.
3. Sekretarët e Byrosë së Kuvendit, në përputhje me detyrat e caktuara nga Byroja, drejtojnë sekretariatet e Kuvendit. Ata informojnë rregullisht Kryetarin dhe Byronë e Kuvendit për veprimtarinë e sekretariatit përkatës.

Neni 10/1
Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit
(Shtuar me vendimin nr. 41/2013)

1. Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit drejtohet nga dy sekretarët për buxhetin, të cilët përfaqësojnë grupet politike të shumicës dhe të opozitës parlamentare. Ata drejtojnë kolegjialisht Sekretariatin për Buxhetin e Kuvendit.
2. Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit mblidhet të paktën një herë në tre muaj.
3. Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit mblidhet edhe me kërkesë të njërit prej sekretarëve të tij, Byrosë së Kuvendit ose të Sekretarit të Përgjithshëm për të shqyrtuar një çështje të caktuar, që ka lidhje me mënyrën e administrimit të buxhetit të Kuvendit.

4. Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit, në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, ndjek dhe mbikëqyr të gjitha procedurat e hartimit të projektbuxhetit vjetor dhe afatmesëm të Kuvendit që në fazën fillestare të tij e deri në propozimin e tij në Byronë e Kuvendit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Pas miratimit nga Byroja e Kuvendit, Sekretariati për Buxhetin, gjatë shqyrtimit të projektligjit të Buxhetit të Shtetit, paraqet në Komisionin për Ekonominë dhe Financat raportin e vlerësimit të projektbuxhetit vjetor të Kuvendit.

6. Sekretariati për Buxhetin, në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, kujdesen edhe për administrimin e veprimtarisë së Kuvendit, në përputhje me buxhetin e Kuvendit.

7. Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit shqyrton buxhetin faktik të Kuvendit, lidhur me realizimin e tij gjatë vitit të mëparshëm financiar.

8. Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit raporton çdo gjashtë muaj në Byronë e Kuvendit për zbatimin e buxhetit të Kuvendit.”.

Neni 11

Thirrja dhe kompetencat e Byrosë së Kuvendit (shtuar pika 6/1 me vendimin nr. 41/2013)

1. Kryetari i Kuvendit thërret mbledhjen e Byrosë së Kuvendit, sipas rendit të ditës të përcaktuar prej tij.
2. Byroja vendos për buxhetin e Kuvendit, sipas propozimit të bërë nga sekretarët për buxhetin; vendos për ankimet në rastet e konstituimit të grupeve parlamentare dhe për ankesat e grupeve parlamentare për përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit.
3. Byroja e Kuvendit, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm, miraton Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimeve të Kuvendit.
4. Byroja e Kuvendit nxjerr vendime dhe udhëzime për sa i përket:

a) organizmit të shërbimeve në Kuvend dhe detyrave të ngarkuara çdo njësie të saj, në përputhje me funksionimin e Kuvendit;

b) statusit ligjor, trajtimit ekonomik dhe kushteve të shërbimit për të punësuarit në Kuvend.

5. Byroja e Kuvendit shqyrton dhe vendos për masat disiplinore të propozuara nga drejtuesi i seancës, sipas nenit 65 pika 2 të kësaj Rregulloreje.

6. Byroja e Kuvendit emëron, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit mbi bazën e tre kandidaturave të dala nga procedura e konkurrimit, sipas ligjit të shërbimit civil.

6/1. Byroja e Kuvendit, me propozimin e Sekretariatit për Buxhetin e Kuvendit, autorizon publikimin e shpenzimeve financiare të kryera nga Kuvendi në faqen zyrtare të internetit çdo dy muaj.

7. Byroja e Kuvendit miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Kuvendit, të përgatitur nga Sekretari i Përgjithshëm dhe vendos për publikimin e tij.

Neni 12

Konferenca e Kryetarëve

(ndryshuar pikat 2 dhe 3 me vendimin nr. 41/2013)

1. Konferenca e Kryetarëve diskuton dhe vendos për programin e punës, kalendarin e punimeve të Kuvendit dhe të komisioneve të tij, si dhe për çështje të zhvillimit të punimeve të Kuvendit në seancë plenare.

2. Konferenca e Kryetarëve përbëhet nga Kryetari i Kuvendit, zëvendëskryetarët e Kuvendit, kryetarët e grupeve parlamentare dhe kryetarët e komisioneve të përhershme parlamentare dhe drejtohet nga Kryetari i Kuvendit. Konferenca thirret nga Kryetari i Kuvendit ose me kërkesën e Këshillit të Ministrave apo të një kryetari grupi parlamentar. Në Konferencën e Kryetarëve merr

pjesë edhe anëtari i Këshillit të Ministrave, i ngarkuar të mbajë lidhjet me Kuvendin.

3. Mbledhjet e Konferencës së Kryetarëve, si rregull, zhvillohen jo më herët se 48 orë nga çasti i njoftimit për mbajtjen e mbledhjes

4. Në Konferencën e Kryetarëve shqyrtohet programi i punës dhe kalendari i punimeve të Kuvendit mbi bazën e propozimit të Kryetarit të Kuvendit. Si rregull, programi i punës dhe kalendari i punimeve miratohen me mirëkuptim nga Konferenca e Kryetarëve dhe kur kjo nuk realizohet, Kryetari ia paraqet ato Kuvendit në seancë plenare, në përputhje me nenet 26 dhe 27 të kësaj Rregulloreje.

5. Në mbledhjet e Konferencës së Kryetarëve mbahen procesverbale të përmbledhura, të cilat bëhen publike dhe u shpërndahen përfaqësuesve të medias ose personave të tjerë.

Neni 13

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin (ndryshuar pika 1 dhe 5 me vendimin nr. 41/2013)

1. Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin përbëhet nga 10 deputetë, të emëruar nga Kryetari i Kuvendi, pasi ka marrë mendimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, në mënyrë që të sigurojnë përfaqësim të barabartë mes shumicës dhe opozitës parlamentare. Këshilli kryesohet nga Kryetari i Kuvendit.

2. Këshilli studion propozimet për ndryshimin e Rregullores, jep mendime për çështje të interpretimit të Rregullores, sipas nenit 116 të kësaj Rregulloreje, si dhe për konfliktet në lidhje me kompetencat ndërmjet komisioneve të Kuvendit.

3. Me kërkesë të Kryetarit të Kuvendit, Këshilli shqyrton kërkesën për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për fillimin e ndjekjes penale ose arrestimin e një deputeti, në përputhje me nenin 118 dhe nëse ka vend për procedim ndaj deputetit të ndaluar ose të arrestuar, sipas nenit 119 të kësaj Rregulloreje.

4. Këshilli shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me mandatin e deputetit dhe paraqet raportin përkatës në seancë plenare.

5. Këshilli verifikon mandatin e deputetit, i cili zgjidhet gjatë legjislaturës dhe paraqet raportin përkatës në seancë plenare brenda 30 ditëve.
6. Këshilli mbledhet në mënyrën e parashikuar nga kjo Rregullore për komisionet e përhershme.

Neni 14
Këshilli për Legjislacionin
(ndryshuar pika 1 me vendimin nr. 41/2013)

1. Këshilli për Legjislacionin përbëhet nga 10 deputetë, të emëruar nga Kryetari i Kuvendi, pasi ka marrë mendimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, në mënyrë që të sigurojnë përfaqësim të barabartë mes shumicës dhe opozitës parlamentare. Anëtarët e Këshillit duhet të jenë me profesion jurist ose të kenë një përvojë të spikatur legjislative.
2. Këshilli për Legjislacionin kryesohet me rotacion çdo 5 muaj nga secili anëtar, duke filluar sipas renditjes alfabetike të mbiemrit të secilit të anëtar të Këshillit.
3. Këshilli shpreh mendimin e tij për projektligjet me kërkesën e komisionit përgjegjës, që ka në shqyrtim projektligjin, ose të Kryetarit të Kuvendit, në përputhje me pikën 4 të këtij neni.
4. Komisioni përgjegjës, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij, ose Kryetari i Kuvendit mund të kërkojnë mendimin e Këshillit për Legjislacionin në lidhje me cilësinë e hartimit të një projektligji, për qartësinë dhe thjeshtësinë e tij, për çështjet kushtetuese ose ligjore që ngrihen në tekstin e tij, si dhe për çështje të tjera, të cilat komisioni ose Kryetari i Kuvendit i konsiderojnë të nevojshme. Kërkesa duhet të paraqitet duke i lejuar Këshillit një kohë të arsyeshme shqyrtimi, si dhe duhet të jetë në përputhje me kalendarin e punimeve të komisionit përgjegjës dhe të harmonizohet me kalendarin e punimeve të Kuvendit. Në mbledhjen e Këshillit merr pjesë relatori në komisionin përgjegjës dhe përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave.

5. Raporti i Këshillit për Legjislacionin i përcillet komisionit përgjegjës për shqyrtimin e projektligjit. Nëse komisioni përgjegjës nuk merr parasysh mendimin e Këshillit, ai paraqet edhe arsyetimin përkatës në raportin për seancën plenare.
6. Këshilli mblidhet në mënyrën e parashikuar nga kjo Rregullore për komisionet e përhershme.

KREU III GRUPET PARLAMENTARE

Neni 15 Formimi i grupeve parlamentare

1. Deputetët mund të formojnë grupe parlamentare sipas përkatësisë partiake ose orientimit politik.
2. Për krijimin e një grupi parlamentar kërkohet një minimum prej 7 deputetësh. Çdo deputet mund të jetë anëtar vetëm i një grupi parlamentar. Një deputet që largohet nga grupi parlamentar, mund t'i bashkohet një grupi tjetër parlamentar vetëm pas gjashtë muajve nga data e largimit.
3. Kur numri i deputetëve të një grupi parlamentar bie nën numrin e parashikuar nga pika 2 e këtij neni, grupi pushon së ekzistuari.
4. Brenda 3 ditëve nga data e zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit, çdo deputet deklaron me shkrim se në cilin grup parlamentar bën pjesë. Vetëm deputetët që nuk bëjnë deklarimin e mësipërm ose që nuk i përkasin asnjë grupi parlamentar mund të formojnë grup të përzier.
5. Çdo deputet ka të drejtë të largohet nga grupi parlamentar. Për këtë ai duhet t'i paraqesë një deklaratë me shkrim kryesisë së grupit dhe të njoftojë me shkrim Byronë e Kuvendit.
6. Deputetët që zgjidhen gjatë legjislaturës, brenda 3 ditëve nga kryerja e betimit, bëjnë deklarimin me shkrim se cilit grupi parlamentar i përkasin.

Neni 16

Kryesia e grupit parlamentar

1. Çdo grup parlamentar, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh kryesinë e tij.
2. Për zgjedhjen e kryesisë, si dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm të përbërjes së grupeve parlamentare ose kryesive të tyre, vihet në dijeni Kryetari i Kuvendit.
3. Kryetari i Kuvendit zhvillon takim me kryetarët e grupeve parlamentare me qëllim përcaktimin e vendeve të grupeve parlamentare në sallën e Kuvendit. Vendet e deputetëve të secilit grup parlamentar përcaktohen nga kryetari i secilit grup.

Neni 17

Kushtet e punës për grupet parlamentare (Shtuar pika 2 me vendimin nr. 41/2013)

1. Grupeve parlamentare u sigurohen mjediset e punës dhe pajisjet e nevojshme për funksionimin e tyre.
2. Çdo grupi parlamentar i vihet në dispozicion një sekretar administrativ dhe një këshilltar, ndërsa grupit më të madh parlamentar të shumicës dhe opozitës edhe tre deri në katër këshilltarë për fusha të caktuara të veprimtarisë parlamentare

KREU IV

KOMISIONET E PËRHERSHME TË KUVENDIT

Neni 18

Kompetencat e komisioneve të përherhme

Komisionet e përhershme të Kuvendit shqyrtojnë sipas përkatësisë projektligjet, projektvendimet dhe çështjet e tjera që paraqiten në Kuvend, kryejnë studime për efektivitetin e ligjeve në fuqi, ndjekin zbatimin e ligjeve dhe kontrollojnë veprimtarinë e ministrive dhe të organeve të tjera qendrore, duke i propozuar Kuvendit ose Këshillit të Ministrave marrjen e masave përkatëse, si dhe propozojnë për miratim në Kuvend projektligje, projektdeklarata ose projektrezoluta.

Neni 19

Komisionet e përhershme dhe nënkomisionet e Kuvendit (ndryshuar pika 1 me vendimin nr. 41/2013)

1. Kuvendi emëron në seancë plenare 8 komisione të përhershme me këto emërtime dhe fusha përgjegjësie:

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

(Kodet dhe organizimi i pushtetit gjyqësor, administrata publike, administrata e pushtetit gjyqësor, organizimi dhe funksionimi i pushtetit vendor, shërbimet e pavarura në sistemin e drejtësisë dhe të drejtat e njeriut).

Komisioni për Integrimin European.

(Çështjet e integritit european, përafrimi i legjislacionit me acquis e Bashkimit European, mbikëqyrja e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, si dhe mbikëqyrja e asistencës financiare të Bashkimit European për Shqipërinë).

Komisioni për Politikën e Jashtme.

(Politika e jashtme, marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare).

Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

(Politikat ekonomike, Buxheti i Shtetit dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij, financat publike, privatizimet dhe sistemi bankar).

Komisioni për Sigurinë Kombëtare.

(Organizimi i mbrojtjes kombëtare dhe Forcat e Armatosura, bashkëpunimi ushtarak, punët e brendshme, emergjencat civile, rendi publik dhe shërbimet sekrete).

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

(Bujqësia, industria, telekomunikacionet, turizimi, rregullimi i territorit, tregtia dhe mbrojtja e mjedisit).

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

(Marrëdhëniet e punës, çështjet sociale, sigurimet shoqërore, familja, gruaja dhe shëndetësia).

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

(Arsimi në çdo nivel, kultura, rinia, shkenca, sportet, media e shkruar dhe vizive).

2. Në përbërje të komisioneve të përhershme, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, mund të ngrihen edhe nënkomisione për probleme të veçanta.

Neni 20

Anëtarësia në komisionet e përhershme

(Ndryshuar pika 2 me vendimin nr. 21, datë 04.03.2010)

1. Në komisionet e përhershme marrin pjesë të gjithë deputetët dhe përbërja e tyre, për aq sa është e mundur, pasqyron grupet parlamentare, sipas përpjesëtimit që zënë në Kuvend. Kryetari i Kuvendit dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave nuk mund të jenë anëtarë të komisioneve të përhershme.

2. Si rregull, deputeti mund të jetë anëtar vetëm i një komisioni të përhershëm. Në respektim të raporteve shumicë parlamentare-opozitë, deputetë të caktuar mund të jenë anëtarë të jo më shumë se dy komisioneve të përhershme. Deputeti mund të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve të tjera, por pa të drejtë vote.

Neni 21

Përbërja e komisioneve të përhershme dhe e nënkomisioneve të Kuvendit

1. Anëtarët e komisioneve të përhershme dhe të nënkomisioneve, së bashku me kryesitë e tyre, zgjidhen me votim të hapur nga Kuvendi me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, duke u mbështetur në listat e kandidatëve të hartuara në marrëveshjen e Kryetarit të Kuvendit me kryetarin e çdo grupi parlamentar.

2. Kuvendi mund të ndryshojë përbërjen e komisioneve të përhershme dhe të nënkomisioneve, duke ruajtur përpjesëtimin që zënë grupet parlamentare në Kuvend. Për ndryshimin e numrit dhe të përbërjes së komisioneve dhe të nënkomisioneve synohet arritja e mirëkuptimit mes grupeve parlamentare.

3. Kuvendi, në seancë plenare, me votim të hapur, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pas këshillimit me kryetarët e grupeve parlamentare, cakton emrat e zëvendësuesve të anëtarëve të komisionit ose të nënkomisionit për secilin grup parlamentar. Anëtari i një komisioni ose nënkomisioni, në rast mungese ose pamundësie për të marrë pjesë në mbledhje, zëvendësohet nga një prej anëtarëve të caktuar në vendimin e Kuvendit. Zëvendësimi autorizohet me shkrim nga kryetari i çdo grupi parlamentar, duke përcaktuar edhe datat e zëvendësimit dhe i dorëzohet kryetarit të komisionit. Zëvendësimi i një anëtari të komisionit të përhershëm ose nënkomisioni nuk mund të ndodhë më shumë se 4 herë gjatë një sesioni të Kuvendit.

Neni 22

Kryesia e komisionit të përhershëm dhe e nënkomisionit

Kryesia e komisionit të përhershëm përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i komisionit, ndërsa ajo e nënkomisionit nga kryetari dhe zëvendëskryetari. Përcaktimi i përbërjes së kryesive të komisioneve të përhershme dhe të

nënkomisioneve bëhet duke mbajtur parasysh përfaqësimin në to të grupeve parlamentare, sipas përpjesëtimit që zënë në Kuvend.

Neni 23

Detyrat e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit të komisionit

1. Kryetari i komisionit të përhershëm përfaqëson komisionin, organizon dhe drejton mbledhjet e komisionit, mban lidhje me organet e tjera, si dhe siguron respektimin e procedurave, sipas kësaj Rregulloreje.
2. Zëvendëskryetari zëvendëson kryetarin në rastet e mungesës së tij ose kur ai nuk ka mundësi të kryejë detyrat.
3. Sekretari verifikon rezultatin e votimit në komision dhe kontrollon e nënshkruan procesverbalin e përmbledhur të mbajtur në mbledhjen e komisionit.

Neni 24

Komisionet e posaçme

1. Kuvendi mund të vendosë krijimin e një komisioni të posaçëm për shqyrtimin dhe përgatitjen e nismave ligjvënëse, si dhe për çështje të një rëndësie të veçantë.
2. Propozimi për krijimin e komisionit të posaçëm mund të bëhet nga Kryetari i Kuvendit, nga një komision i përhershëm ose nga të paktën 7 deputetë. Kryetari i Kuvendit, brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës, thërret Konferencën e Kryetarëve për të diskutuar rreth kërkesës për ngritjen e komisionit të posaçëm.
3. Kuvendi, brenda 2 javëve nga diskutimi në Konferencën e Kryetarëve, përcakton sipas propozimit të Konferencës detyrat, numrin, përbërjen dhe afatin kohor të veprimtarisë së komisionit të posaçëm.

4. Rregullat procedurale, të përcaktuara në nenet 32-41 të kësaj Rregulloreje, zbatohen edhe për komisionet e posaçme, me përjashtim të rastit kur në vendimin e krijimit të tyre përcaktohet ndryshe.

Neni 25 **Komisionet hetimore**

1. Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesën e një të katërtës së të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë një komision hetimi, për të shqyrtuar një çështje të veçantë.
2. Komisionet hetimore të Kuvendit veprojnë sipas procedurës së parashikuar me ligj.

KREU V **ORGANIZIMI I PUNIMEVE TË KUVENDIT** **DHE TË KOMISIONEVE TË TIJ**

Neni 26 **Programi i punës së Kuvendit** **(Ndryshuar pika 2 me vendimin nr. 41/2013)**

1. Kuvendi i zhvillon punimet në seancë plenare dhe në komisione, sipas një programi të caktuar.
2. Programi i punës së Kuvendit përcaktohet nga Konferenca e Kryetarëve për një periudhë nga 4 deri në 12 javë, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pasi ka marrë më parë mendimin e anëtarit të Këshillit të Ministrave, i ngarkuar të mbajë lidhjet me Kuvendin, të kryetarëve të komisioneve të përhershme dhe të shërbimit juridik në Kuvend. Në mbledhje merr pjesë edhe anëtari i Këshillit të Ministrave. Projektprogrami i punës u jepet anëtarëve të Konferencës së Kryetarëve dhe anëtarit të Këshillit të Ministrave të paktën 4 ditë para zhvillimit të mbledhjes.

3. Programi i punës përmban listën e çështjeve që do të shqyrtojë Kuvendi. Në të shënohen institucioni që ka ndërmarrë nismën, data e paraqitjes, si dhe komisioni përgjegjës që ngarkohet me shqyrtimin e tij. Si komision përgjegjës Kryetari propozon një komision të përhershëm dhe, në rastet kur e sheh të nevojshme, ai propozon mbledhje të përbashkët të dy komisioneve të përhershme ose ngritjen e një komisioni të posaçëm.

4. Projektligjet për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare shqyrtohen nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, nga Komisioni për Politikën e Jashtme, nga komisioni që mbulon fushën në të cilën është bërë marrëveshja dhe, nëse marrëveshja ka efekte financiare, nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

5. Programi i punës miratohet me mirëkuptim në Konferencën e Kryetarëve dhe i njoftohet Kuvendit. Për programin e punës çdo deputet, në seancë plenare, për jo më shumë se 3 minuta, mund të bëjë propozime, për të cilat Kuvendi vendos me votim të hapur.

6. Në rast se në Konferencën e Kryetarëve nuk arrihet mirëkuptimi për programin e punës së Kuvendit, ai hartohet nga Kryetari për një periudhë 3 - javore dhe i paraqitet për miratim Kuvendit në seancë plenare. Në programin e paraqitur Kryetari merr në konsideratë propozimet e bëra nga Këshilli i Ministrave dhe kryetarët e grupeve parlamentare. Për shqyrtimin e propozimeve për ndryshime në program, të propozuara me shkrim nga një grup prej 7 deputetësh ose nga Këshilli i Ministrave, votohet pa debat në seancë plenare, pasi është dëgjuar për jo më shumë se 5 minuta një folës pro dhe një folës kundër.

7. Në programin e punës së Kuvendit futen automatikisht dekretet e Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligjesh, emërime, për të cilat kërkohet pëlqimi i Kuvendit, projektligje financiare ose ndryshimi i Buxhetit të Shtetit, shqyrtimi i akteve normative me fuqinë e ligjit, propozimet për emërim dhe shkarkim titullarësh të organeve që zgjidhen nga Kuvendi, mocionet e kërkuara, projektligjet ose projektvendimet e mbartuara nga programi

paraardhës, si dhe çështjet që lidhen me gjendjen e jashtëzakonshme.

Neni 27

Kalendari i punimeve të Kuvendit

1. Për zbatimin e programit të punës së Kuvendit, Kryetari i Kuvendit i propozon Konferencës së Kryetarëve kalendarin e punimeve të Kuvendit për një periudhë 3 - javore. Në mbledhje merr pjesë edhe anëtari i Këshillit të Ministrave, i ngarkuar të mbajë lidhjet me Kuvendin. Projektkalendari i punimeve u jepet kryetarëve të grupeve parlamentare dhe anëtarit të Këshillit të Ministrave të paktën 4 ditë para zhvillimit të mbledhjes.
2. Në kalendarin e punimeve për çdo çështje shënohet komisioni përgjegjës që do të shqyrtojë çështjen, komisionet e përhershme që mund të japin mendim për nene ose çështje të veçanta dhe emri i relatorit/relatorëve.
3. Kalendari i miratuar me mirëkuptim në Konferencën e Kryetarëve bëhet i detyrueshëm për zbatim pasi i njoftohet Kuvendit.
4. Kur në Konferencën e Kryetarëve nuk arrihet mirëkuptimi për kalendarin e punimeve, Kryetari i Kuvendit e harton vetë atë dhe ia paraqet për miratim Kuvendit në seancë plenare. Pas diskutimit për jo më shumë se 10 minuta për çdo grup parlamentar, kalendarin përfundimtar miratohet në Kuvend. Këshilli i Ministrave, një kryetar grupi parlamentar ose 7 deputetë mund të paraqesin me shkrim propozime për ndryshime në kalendarin e punimeve. Kuvendi vendos me votim të hapur, pasi dëgjon për jo më shumë se 5 minuta një folës pro dhe një folës kundër ndryshimeve të paraqitura.
5. Kalendari i punimeve të Kuvendit përmban në mënyrë të detajuar kohën kur Kuvendi zhvillon punimet në seancë plenare dhe në komisione. Kalendari publikohet dhe u shpërndahet deputetëve, si dhe u vihet në dispozicion përfaqësuesve të medias.

Në çdo rast, rendi i ditës duhet të jetë bërë publik të paktën 2 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e komisionit ose seancës plenare.

Neni 28

Procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të projektligjeve

1. Me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një të pestës së të gjithë numrit të deputetëve, Kuvendi mund të shqyrtojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar.
2. Procedura e përshpejtuar nuk lejohet për shqyrtimin e projektligjeve të parashikuara në nenin 81 pika 2 të Kushtetutës, me përjashtim të shkronjës “dh”.
3. Kërkesa për procedurë të përshpejtuar të shqyrtimit të projektligjit paraqitet me shkrim te Kryetari i Kuvendit, i cili ia njofton Kuvendit në seancën plenare më të parë. Pas njoftimit të Kryetarit dëgjohet një folës pro dhe një folës kundër për jo më shumë se 10 minuta. Kryetari i Kuvendit i paraqet Kuvendit për votim projektvendimin përkatës, në të cilin përcaktohet data e shqyrtimit të projektligjit në komisionin përgjegjës, afati brenda të cilit mund të propozohen amendamente dhe data e shqyrtimit në seancë plenare. Konferenca e Kryetarëve mund të përcaktojë kohën e debatit në seancë plenare, duke respektuar rregullin e parashikuar në nenin 48 pika 3 të kësaj Rregulloreje.
4. Afati, brenda të cilit duhet të shqyrtohet çështja në komision dhe në seancë plenare, nuk mund të jetë më pak se një javë nga data e paraqitjes së kërkesës nga Kryetari i Kuvendit në seancë plenare.
5. Kuvendi nuk mund të shqyrtojë më shumë se tri projektligje me procedurë të përshpejtuar për programin 12-javor të punës së Kuvendit dhe një projektligj për programin 3-javor të punës së tij.

Neni 29

Programi i punës dhe kalendari i punimeve të komisioneve të përhershme

1. Çdo komision i përhershëm përcakton programin e punës dhe kalendarin e punimeve të tij. Ata hartohen duke mbajtur parasysh programin e punës dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit dhe në mënyrë që raporti i komisionit për shqyrtimin e projektligjit t'i paraqitet Kuvendit jo më vonë se 3 ditë para zhvillimit të seancës plenare.
2. Kryetari i komisionit, në këshillim me zëvendëskryetarin dhe sekretarin e komisionit, nisur nga rëndësia e çështjes që do të shqyrtohet, cakton një ose më shumë relatorë për çështjen dhe ia bën të ditur komisionit. Në rast kundërshtimi, komisioni vendos për caktimin e relatorit/relatorëve me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 30

Njoftimi i rendit të ditës dhe i mbledhjes pasardhëse

1. Në fillim të çdo seance plenare drejtuesi i saj bën të njohur rendin e ditës, në përputhje me kalendarin e punimeve.
2. Drejtuesi i seancës plenare ose kryetari i komisionit, para se të mbyllë përkatësisht seancën ose mbledhjen, njofton orën e fillimit të seancës plenare ose të mbledhjes së ardhshme.

Neni 31

Ndryshimi i rendit të ditës

1. Kuvendi ose komisionet nuk mund të diskutojnë dhe të vendosin për çështje që nuk janë në rendin e ditës.
2. Për të diskutuar ose vendosur në seancë plenare për çështje që nuk janë në rendin e ditës, Kuvendi merr vendim me jo më pak se tre të pestat e deputetëve të pranishëm. Propozimet për vendosje të

çështjeve të tjera në rend të ditës duhet të paraqiten me shkrim nga të paktën 10 deputetë, nga një kryetar grupi parlamentar ose nga Këshilli i Ministrave vetëm para fillimit të seancës, para fillimit të diskutimit të një pike të rendit të ditës ose kur është pezulluar diskutimi. Në rastet kur kërkesën nuk e bën grupi parlamentar, kërkesa paraqitet nga një deputet dhe grupi mbështetës i deputetëve ngrihet në këmbë.

3. Kuvendi mund të vendosë në çdo kohë që komisionet e përhershme të kenë në rendin e tyre të ditës një ose më shumë çështje, në përputhje me programin e punës dhe me kalendarin e punimeve të Kuvendit.

KREU VI ZHVILLIMI I MBLEDHJEVE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME

Neni 32

Mbledhjet e komisioneve

1. Komisionet e përhershme mblidhen si në kohën kur Kuvendi është i mbledhur në sesion, ashtu edhe jashtë tij.
2. Mbledhjet e komisionit të përhershëm thirren nga kryetari i tij. Ato mund të thirren edhe me kërkesën e jo më pak se një të katërtës së anëtarëve të komisionit ose me kërkesën e Kryetarit të Kuvendit, duke përcaktuar në kërkesë dhe çështjet që do të diskutohen në mbledhje.
3. Komisionet e përhershme nuk mund të mblidhen gjatë kohës kur Kuvendi zhvillon punimet në seancë plenare, përveçse me miratimin e Kryetarit të Kuvendit. Për të siguruar numrin e kërkuar për votim, drejtuesi i seancës plenare ka të drejtë në çdo kohë të anulojë ose të ndërpresë mbledhjen e komisionit.
4. Në mbledhjet e komisioneve mund të marrin pjesë pa të drejtë vote edhe deputetë që nuk janë anëtarë të tij, anëtarët e Këshillit të Ministrave, si dhe persona të tjerë të ftuar nga komisioni.

Neni 33

Organizimi i punës

1. Kryetari i komisionit, në këshillim me zëvendëskryetarin dhe sekretarin e komisionit, i propozon për miratim komisionit programin e punës dhe kalendarin e punimeve të tij. Kryetari i komisionit përgatit rendin e ditës, organizon punën për zhvillimin e mbledhjeve të komisionit dhe kryeson mbledhjet e tij; përfaqëson komisionin në marrëdhënie me organet e tjera të Kuvendit dhe jashtë tij; nënshkruan dhe paraqet në seancë plenare, së bashku me relatorin, raportin e shqyrtimit të çështjes në komision; vë në dukje pjesëmarrjen në komision; hedh në votë dhe shpall rezultatin e votimit, si dhe ndjek korrespondencën e komisionit. Me pëlqimin e kryesisë së komisionit ose kur kjo kërkohet nga shumica e anëtarëve të komisionit, kryetari thërret për raportim ose informim para komisionit drejtuesit e institucioneve shtetërore dhe publike.
2. Kryetari i komisionit informon komisionin për çdo veprimtari që kryen në emër të tij.

Neni 34

Kuorumi dhe vendimmarrja në komision

1. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme kur në to merr pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të komisionit.
2. Komisioni merr vendim me votim të hapur për programin e punës dhe kalendarin e punimeve të tij, për miratimin e raportit që do t'i paraqitet seancës plenare, për projektrezoluta ose projektdeklarata që i paraqiten Kuvendit për miratim, si dhe për çështje të tjera që lidhen me funksionimin e komisionit. Vendimet merren me shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të komisionit.

3. Mendimi i anëtarëve që kanë mbetur në pakicë, në çdo rast shënohet në procesverbalin e përmbledhur të mbledhjes së komisionit dhe i bashkëngjitet mendimit të shumicës së komisionit.

Neni 35

Publiciteti i mbledhjeve

1. Mbledhjet e komisionit, si rregull, bëhen të hapura. Mbledhja quhet e hapur kur media, grupet e interesit ose vizitorët janë të lejuar ta ndjekin atë.
2. Komisioni, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij, mund të vendosë që mbledhjet e komisionit ose pjesë të tyre të bëhen të mbyllura.

Neni 36

Seancat dëgjimore publike

(Shtuar pika 1/1 me vendimin nr. 41/2013)

1. Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara. Komisioni është i detyruar të realizojë seancën dëgjimore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, në rast se një e treta e të gjithë anëtarëve të komisionit e kërkon atë në mënyrë të motivuar me shkrim.

1/1. Gjatë procesit legjislativ, komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 të këtij neni. Komisioni nuk mund të përgatisë raportin për seancë plenare pa u realizuar seanca dëgjimore

2. Në përgatitjen e seancës dëgjimore publike, kryetari, në bashkëpunim me zëvendëskryetarin dhe sekretarin e komisionit, i paraqet të ftuarve çështjet për të cilat kërkohet informacion.

Neni 37

Mbledhjet e përbashkëta të komisioneve

1. Komisionet, kur përcaktohet në programin e punës së Kuvendit ose kur e shohin të nevojshme, mund të bëjnë mbledhje të përbashkëta. Mbledhjen e përbashkët e kryeson njëri nga kryetarët e komisionit që zgjidhet me marrëveshje ndërmjet tyre dhe, kur kjo nuk arrihet, mbledhjen e kryeson kryetari i atij komisioni që ka më tepër lidhje me çështjen në shqyrtim, i caktuar nga Kryetari i Kuvendit.

2. Në mbledhjet e përbashkëta të komisioneve zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 34, 35 dhe 36 të kësaj Rregulloreje dhe vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

3. Mbledhjet e përbashkëta të komisioneve dalin me një raport të vetëm. Kur qëndrimet e komisioneve janë të ndryshme, ato paraqiten veçmas në raportin përfundimtar të mbledhjes.

Neni 38

Shqyrtimi i çështjeve

(Ndryshuar pika 5 me vendimin nr. 41/2013)

1. Brenda 2 ditëve nga përcaktimi në seancë plenare i programit të punës dhe i kalendarit të punimeve të Kuvendit, komisioni mblidhet për miratimin e programit të punës dhe kalendarit të punimeve të tij. Programi i punës dhe kalendari i punimeve të komisionit duhet të garantojnë zbatimin në kohë të çështjeve që janë parashikuar për shqyrtim në seancë plenare.

2. Në komisionin përgjegjës për shqyrtimin e çështjes caktohet relatori/relatorët e çështjes, në përputhje me nenin 29 pika 2 të kësaj Rregulloreje. Relatorët caktohen në mbledhjen ku miratohet programi i punës së komisionit dhe për çdo çështje që është në program. Mendimi i relatorit/relatorëve për çështjen duhet të jepet me shkrim dhe të paktën 3 ditë përpara datës së caktuar për të shqyrtuar çështjen në komision. Për hartimin e raportit relatori/relatorët mund të kërkojnë të ndihmohen nga specialistë të Këshillit të Ministrave të lidhur me çështjen, nga shërbimi juridik në Kuvend, si dhe nga ekspertë të tjerë.

3. Komisioni përgjegjës fillimisht kryen diskutimin në parim të projektligjit ose të çështjes. Relatori paraqet vlerësimin e përgjithshëm mbi projektligjin ose çështjen që diskutohet dhe, nëse e sheh të arsyeshme, i propozon komisionit të kërkojë mendimin e Këshillit për Legjislacionin, sipas nenit 14 të kësaj Rregulloreje. Kryetari i komisionit, pas dëgjimit të relatorit, fton anëtarët e komisionit për pyetje drejtuar nismëtarëve të projektligjit dhe relatorit dhe, pas kësaj, deklaron të hapur diskutimin në parim për projektligjin. Diskutimi në parim bëhet gjithmonë në prani të përfaqësuesit të Këshillit të Ministrave. Në përfundim të diskutimit në parim, komisioni vendos për miratimin në parim ose mosmiratimin e projektligjit.

4. Çdo deputet ka të drejtë të dëgjohet në mbledhjen e komisionit përgjegjës për mendimin e tij në lidhje me projektligjin që shqyrton komisioni.

5. Në rast se komisioni përgjegjës miraton në parim projektligjin, ai fillon shqyrtimin dhe votimin nen për nen të tij dhe për çështjet që propozohen për t'i kërkuar mendim Këshillit për Legjislacionin ose komisioneve të tjera, vendos me votim nëse duhet t'u dërgohen ose të mos u dërgohen. Shqyrtimi i këtyre pikave kryhet pasi është marrë mendimi i Këshillit për Legjislacionin ose i komisionit të përhershëm. Raporti i Komisionit për Integrimin European është i detyrueshëm për t'u shqyrtuar nga komisioni përgjegjës para miratimit në tërësi të projektligjit

6. Kur komisioni përgjegjës vendos mosmiratimin në parim të projektligjit, ose kur mendimi i Këshillit për Legjislacionin është për mosmiratimin në parim të tij, çështja vendoset për diskutim në seancë plenare. Kur Kuvendi në seancë plenare vendos miratimin në parim të projektligjit, komisioni përgjegjës fillon shqyrtimin nen për nen të tij në mbledhjen më të parë.

Neni 39

Procesverbalet në mbledhjet e komisioneve

1. Në mbledhjet e komisioneve mbahet procesverbal i përmbledhur.
2. Në procesverbalin e përmbledhur shënohet data e zhvillimit të mbledhjes, çështja që shqyrtohet, pjesëmarrja e deputetëve dhe e të ftuarve, përmbledhja e diskutimeve të bëra, qëndrimet e deputetëve dhe rezultati i votimit. Procesverbali i përmbledhur paraqitet në mbledhjen më të parë pasardhëse të komisionit. Në rast se në mbledhjen e komisionit nuk ka vërejtje për procesverbalin e mbledhjes paraardhëse, procesverbali quhet i pranuar dhe nëse kërkohet votim, ai zhvillohet me ngritjen e dorës. Për procesverbalin fjala u jepet vetëm atyre anëtarëve të komisionit që kërkojnë të propozojnë korrigjim ose të sqarojnë mendimin që kanë shprehur.
3. Në rast se çështja është me interes të veçantë, me vendim të komisionit, mbledhja regjistrohet e plotë dhe bëhet publike.
4. Në çdo rast procesverbalet e përmbledhura të mbledhjes së komisioneve, me përjashtim të atyre që përmbajnë informacion të klasifikuar sekret shtetëror, bëhen publike dhe u shpërndahen përfaqësuesve të medias ose personave të tjerë.
5. Procesverbali i përmbledhur i mbledhjes së komisionit është dokument parlamentar dhe depozitohet në Arkivin e Dokumentacionit Parlamentar.

Neni 40
Veprimtaria parlamentare
(Shtuar pika 2/1 me vendimin nr. 41/2013)

1. Deputetët janë në veprimtari parlamentare kur ata marrin pjesë në seancë plenare dhe në mbledhjet e komisioneve ose të këshillave; kur marrin pjesë në veprimtari parlamentare brenda ose jashtë vendit, duke njoftuar më parë sekretarinë e Kuvendit, si dhe kur janë në mbledhjet e grupeve parlamentare ose në grupe të ndryshme pune të ngritura nga Kuvendi ose nga komisionet e Kuvendit. Procedurat dhe kriteret për vlerësimin e pjesëmarrjes së deputetëve në veprimtarinë parlamentare përcaktohen nga Byroja e Kuvendit.

2. Anëtarët e komisionit duhet të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e komisionit. Kur një anëtar i tij mungon pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se tri mbledhje rresht gjatë një sesioni, komisioni mund të vendosë që kryetari i komisionit t'i kërkojë, në seancë plenare, grupit parlamentar përkatës zëvendësimin e anëtarit të komisionit.

2/1. Veprimtaria e komisioneve të përhershme parlamentare mbështetet nga programi “Për aktivitetin parlamentar” në buxhetin e Kuvendit.

3. Anëtarët e Kuvendit, gjatë veprimtarisë së tyre, zbatojnë Kodin e Sjelljes.

Neni 41
Aktivizimi i specialistëve të jashtëm

Komisionet ose këshillat, në përputhje me vendimin e Byrosë së Kuvendit, për realizimin e detyrave të tyre mund të aktivizojnë specialistë të fushave të ndryshme.

KREU VII

ZHVILLIMI I SEANCAVE PLENARE

Neni 42

Sesionet e punimeve të Kuvendit (Ndryshuar pika 1 me vendimin nr. 41/2013)

1. Kuvendi i zhvillon punimet vjetore në dy sesione. Sesioni i parë i punimeve të Kuvendit fillon të hënën e tretë të janarit, ndërsa sesioni i dytë të hënën e parë të shtatorit. Data e mbarimit të sesionit dhe ora e fillimit të sesionit të ri të punimeve të Kuvendit njoftohen nga Kryetari i Kuvendit. Fillimi i çdo sesioni të ri parlamentar bëhet me seancë plenare të Kuvendit.

2. Kuvendi thirret në sesion të jashtëzakonshëm me kërkesë të motivuar me shkrim të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit ose të paktën një të pestës së të gjithë deputetëve. Kryetari thërret mbledhjen e Kuvendit jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e kërkesës, mbi bazën e një rendi dite të mbledhjeve të komisioneve dhe të seancës plenare të përcaktuar prej tij.

Neni 43

Publiciteti i seancave plenare

1. Seancat plenare të Kuvendit bëhen të hapura, me përjashtim të rastit kur Kuvendi vendos ndryshe.

2. Kërkesën për të zhvilluar seancë plenare të mbyllur mund ta bëjë Presidenti i Republikës, Kryeministri ose të paktën një e pesta e të gjithë deputetëve, duke e motivuar atë. Pas dëgjimit të kërkesës dhe diskutimeve rreth saj, vendoset me votim të hapur me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Kur vendoset zhvillimi i seancës plenare të mbyllur, drejtuesi i seancës u kërkon personave të ftuar, medias dhe personave nga publiku të largohen nga salla.

3. Nuk mund të zhvillohen seanca plenare të mbyllura gjatë shqyrtimit të Buxhetit të Shtetit ose projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.

Neni 44

Fillimi i seancës plenare

1. Kryetari i Kuvendit ose Zëvendëskryetari i autorizuar prej tij, sipas nenit 9 të kësaj Rregulloreje, hap dhe mbyll seancën plenare të Kuvendit.

2. Seanca plenare fillon me miratimin e procesverbalit të seancës së mëparshme. Kur nuk ka vërejtje për tekstin, ai quhet i miratuar dhe, nëse kërkohet, ai votohet me ngritjen e dorës. Për procesverbalin fjala u jepet vetëm deputetëve që kërkojnë të propozojnë korrigjim ose të saktësojnë mendimin e tyre të shprehur në seancën paraardhëse për jo më shumë se 2 minuta. Procesverbalet, pas pranimit, nënshkruhen nga Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari që drejton Sekretariatit për Procedurat dhe Votimet, bëhen publike dhe ruhen në Arkivin e Dokumentacionit Parlamentar.

3. Në fillim të seancës plenare, drejtuesi i saj ose një prej anëtarëve të Sekretariatit për Procedurat dhe Votimet i caktuar prej tij, njofton projektligjet e depozituara në Kuvend, mesazhet dhe petitionet drejtuar Kuvendit, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e Kryetarit ose vendimet e Byrosë së Kuvendit. Nuk njoftohen petitionet anonime dhe ato që kanë përmbajtje të kundërligjshme.

Neni 45

Çështje që s'janë në rendin e ditës

(ndryshuar me vendimin e Kuvendit nr. 88, datë 24.2.2011)

Në fund të rendit të ditës çdo deputet mund të diskutojë për çështje të ndryshme që ai i konsideron se duhen bërë publike në seancë plenare. Në këtë rast deputeti nuk mund të flasë më shumë se 5 minuta dhe, nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Drejtuesi i seancës kujdeset të harmonizojë diskutimet e çdo deputeti, sipas përkatësisë në grupin parlamentar. Koha e përgjithshme për diskutimin e këtyre çështjeve nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta. Në rast se me diskutime kalohet ky afat, Kryetari i Kuvendit ndërpret diskutimet e deputetëve dhe atyre që kanë ngelur pa diskutuar u jepet fjala në fund të seancës plenare pasardhëse.

Neni 46

Diskutimet në seancë plenare

1. Çdo deputet që dëshiron të diskutojë për një çështje të përfshirë ose të papërfshirë në rendin e ditës duhet të regjistrohet në sekretari para fillimit të seancës plenare. Lista e diskutuesve të regjistruar i bëhet e njohur deputetëve në fillim të seancës plenare.
2. Diskutimet fillojnë pasi drejtuesi i seancës njofton hapjen e tyre. Asnjë deputet nuk mund të diskutojë pa iu dhënë fjala nga drejtuesi i seancës plenare.
3. Fjala kërkohet me ngritjen e dorës ose nëpërmjet sistemit elektronik, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.
4. Lejohet ndërrimi i radhës së diskutimeve ndërmjet deputetëve në marrëveshje mes tyre.
5. Deputeti, i cili, kur i jepet fjala nga drejtuesi i seancës, nuk është në sallë, konsiderohet se ka hequr dorë nga diskutimi.
6. Drejtuesi i seancës u jep fjalën diskutuesve, sipas regjistrimit paraprak, duke harmonizuar pjesëmarrjen për çdo grup parlamentar. Kur lista e diskutuesve ka përfunduar ose nuk e kërkon më fjalën ndonjë deputet tjetër, Kryetari u jep fjalën

kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare, duke filluar nga grupi më i vogël në numër.

Neni 47

E drejta e fjalës për ministrat (Shtuar pika 1/1 me vendimin nr. 41/2013)

1. Anëtarët e Këshillit të Ministrave kanë të drejtë, dhe kur u kërkohet e kanë për detyrë, të marrin pjesë në seancë plenare ose në mbledhjet e komisioneve dhe nënkomisioneve. Atyre u jepet fjala sa herë që e kërkojnë. Në debatet me kohë të përcaktuar, fjala e anëtarit të Këshillit të Ministrave llogaritet në kohën e grupit parlamentar të cilit i përket.

1/1. Për paraqitjen e projektligjeve, Kryeministri dhe ministri kundërfirmues kanë të drejtë të flasin pa kufizim kohor. Gjatë diskutimeve të tjera ministrat kanë të drejtë të marrin fjalën dhe atyre u jepet sa herë e kërkojnë, por jo më shumë se 10 minuta për çdo ndërhyrje.

2. Kur anëtarët e Këshillit të Ministrave kërkojnë të flasin pas mbylljes së diskutimeve, rihapet diskutimi i çështjes që është në shqyrtim.

Neni 48

Koha e diskutimeve

1. Çdo diskutues, me përjashtim të rasteve kur në këtë Rregullore parashikohet ndryshe, ka të drejtë të flasë jo më shumë se 10 minuta. Diskutuesi nuk mund të flasë më shumë se një herë për thelbin e së njëjtës çështje dhe nuk mund të marrë nga koha e një diskutuesi tjetër.

2. Koha e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dyfishohet kur diskutohet programi politik dhe përbërja e Këshillit të Ministrave, mocionet e besimit ose mocionet e mosbesimit, projektligj që

kërkon miratimin me shumicë të cilësuar sipas Kushtetutës, zgjedhje, emërim ose shkarkim titullarësh të organeve që zgjidhen nga Kuvendi ose ratifikim marrëveshjesh ndërkombëtare.

3. Kur çmohet e nevojshme për çështje konkrete, koha e diskutimeve mund të përcaktohet paraprakisht në Konferencën e Kryetarëve në mënyrë përpjesëtimore ndërmjet grupeve, sipas përfaqësimit të tyre në Kuvend, por në çdo rast jo më pak se 10 minuta për një grup parlamentar.

Neni 49

Çështje të procedurës

1. Për çështje të procedurës fjala jepet menjëherë. Janë çështje të procedurës kërkesat që kanë të bëjnë me zbatimin e Rregullores, kërkesat që përmbajnë propozime për ndryshime ose plotësime të rendit të ditës të miratuar, kërkesat për ndërprerjen ose shtyrjen e seancës plenare ose të diskutimeve, si dhe kërkesat që kanë të bëjnë me mënyrën e marrjes së vendimeve ose kryerjes së votimit.

2. Ndërhyrjet për çështjet e procedurës bëhen shkurtimisht dhe pa prekur thelbin e çështjes kryesore.

3. Në këto raste, përveç propozuesit që diskuton jo më shumë se 3 minuta, kanë të drejtë të diskutojnë një folës pro dhe një folës kundër jo më shumë se 2 minuta secili dhe merret vendim me votim të hapur nga Kuvendi me ngritjen e dorës.

Neni 50

Replika

Deputeti ka të drejtën e replikës, kur ndaj tij janë shprehur fjalë të padenja apo të pahijshme, ose janë bërë diskutime që kanë shtrembëruar thelbin e fjalës së tij. Replika bëhet menjëherë pas diskutimit dhe nuk mund të zgjasë më shumë se 2 minuta. Për të njëjtin diskutim deputeti nuk mund të bëjë më shumë se një

replikë. Deputeti, si dhe deputetë të tjerë nuk lejohen të bëjnë replikë ndaj replikës.

Neni 51

Sqarimi i votës kundër

Deputeti ka të drejtën e sqarimit të arsyeve të votimit kundër deri në 2 minuta. Kur kërkohet të bëhet sqarim për votimin kundër, atij i jepet fjala menjëherë pas votimit.

Neni 52

Ndërprerja e seancës plenare

Drejtuesi i seancës, kur çmohet prej tij ose me kërkesën e një grupi parlamentar apo të një komisioni të përhershëm, mund ta ndërpresë seancën plenare për jo më shumë se 60 minuta dhe vetëm një herë për të njëjtën çështje.

Neni 53

Mbajtja e qetësisë nga publiku

1. Personat e ftuar dhe publiku që ndjekin punimet e Kuvendit në seancë plenare, nuk duhet të shprehin shenja miratimi ose mosmiratimi dhe janë të detyruar të respektojnë rregullat e përcaktuara nga Byroja e Kuvendit për mbajtjen e qetësisë. Në rast shkeljeje të tyre, drejtuesi i seancës plenare urdhëron largimin e tyre nga salla.
2. Në rast se nuk është i mundur identifikimi i shkelësit të rregullave, drejtuesi i seancës plenare urdhëron largimin e të gjithë pjesëmarrësve në seksionin e galerisë ku u krye shkelja.

Neni 54
Regjistrimi dhe publikimi i diskutimeve
(Ndryshuar pika 1 me vendimin nr. 41/2013)

1. Seancat plenare të Kuvendit regjistrohen në mënyrë të plotë. Si rregull, për seancat plenare të Kuvendit mbahet edhe procesverbal i përmbledhur. Në procesverbalin e përmbledhur shënohet data e zhvillimit të seancës plenare dhe rendi i ditës së saj, pjesëmarrja e deputetëve, përmbledhja e diskutimeve dhe e qëndrimeve të mbajtura nga deputetët, si dhe rezultatet e votimit. Çdokush ka të drejtë të njihet me përmbajtjen e procesverbaleve të Kuvendit para botimit. Procesverbalet publikohen në faqen e internetit të Kuvendit.
2. Diskutimet në seancat plenare botohen të plota.
3. Procesverbalet, diskutimet, si dhe regjistrimi audiovizual, që bëhen gjatë zhvillimit të seancës plenare të mbyllur, arkivohen dhe administrohen sipas rregullave të përcaktuara për sekretin shtetëror.

KREU VIII
VERIFIKIMI I NUMRIT TË DEPUTETËVE
DHE VOTIMI

Neni 55
Kuorumi dhe vendimmarrja në seancë plenare

1. Ligjet, vendimet, deklaratat dhe rezolutat konsiderohen të miratuara nga Kuvendi kur për to kanë votuar pro shumica e deputetëve, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit, me përjashtim të rasteve kur në Kushtetutë parashikohet shumicë e cilësuar për miratimin e tyre.
2. Për çështje të veçanta, që lidhen me mirëfunksionimin e Kuvendit, vendoset me shumicën e përcaktuar në këtë Rregullore.

3. Drejtuesi i seancës plenare, në leximin e rendit të ditës, i njofton Kuvendit edhe shumicën që kërkon miratimi i projektligjit ose i projektvendimit.

Neni 56

Verifikimi i kuorumit

1. Përpara çdo votimi, drejtuesi i seancës plenare verifikon numrin e deputetëve të pranishëm në sallë.
2. Drejtuesi i seancës, në çdo kohë, si dhe kur kjo kërkohet nga të paktën 7 deputetë, verifikon nëse në sallë është i pranishëm numri i kërkuar i deputetëve. Kërkesa për verifikimin e numrit të deputetëve të pranishëm shprehet me ngritjen në këmbë të kërkuarëve. Për verifikimin e numrit të deputetëve, drejtuesi i seancës bën thirrjen në mënyrë elektronike ose nominale.
3. Kur mungon numri i kërkuar i deputetëve për marrjen e vendimit, drejtuesi i seancës shtyn seancën për 60 minuta dhe në rast se edhe pas kësaj kohe nuk arrihet numri i kërkuar, e anulon atë. Në rast anulimi, drejtuesi i seancës plenare përcakton ditën e nesërme, me kusht që ajo të mos jetë ditë pushimi, si ditë në të cilën Kuvendi do të mblidhet me të njëjtin rend dite, duke deklaruar njëkohësisht edhe orën e votimit për atë rend dite.

Neni 57

Votimi

1. Votimi është vetjak.
2. E drejta e votës nuk delegohet.
3. Votimi bëhet i hapur ose i fshehtë.
4. Me fillimin e votimit nuk lejohet të bëhen më diskutime dhe as i jepet fjala ndokujt deri në shpalljen e rezultatit të votimit. Votimi nuk ndërpritet për asnjë arsye.

Neni 58
(ndryshuar me vendimin nr. 41, datë 24.06.2010)
Votimi i hapur

1. Votimi i hapur bëhet me ngritjen e dorës ose nëpërmjet mjeteve elektronike.
2. Votimi bëhet përherë i hapur në rastet e miratimit të programit politik dhe të përbërjes së Këshillit të Ministrave, të shqyrtimit të dekretit të Presidentit të Republikës, të votimit të Buxhetit të Shtetit ose të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.

Neni 59
Votimi nominal

1. Votimi nominal mund të kërkohet nga të paktën 7 deputetë dhe vendoset me votim nga Kuvendi. Kërkesa për votim nominal duhet të formulohet në kohën që drejtuesi i seancës mbyll diskutimet, deklaron se do të kalohet në votim dhe përpara se të ketë ftuar deputetët të votojnë me ngritjen e dorës ose nëpërmjet mjeteve elektronike.
2. Në votimin nominal drejtuesi i seancës ose sekretari i caktuar prej tij thërret deputetët sipas rendit alfabetik të mbiemrit të tyre dhe ata përgjigjen me zë të lartë pro, kundër ose abstenim.
3. Në rastin e mocionit të besimit ose të mocionit të mosbesimit votimi në Kuvend bëhet kurdoherë nominal.
4. Në rastin e votimit nominal, lista e deputetëve votues me shënimin e votës pro, kundër ose abstenim të secilit deputet, publikohet së bashku me materialet e seancës plenare.

Neni 60

**(Shtuar pika 1/1 me vendimin nr. 41, datë 24.06.2010,
ndryshuar pika 3, shtuar pikat 3/1 dhe 5 me vendimin nr.
41/2013)**

Votimi i fshehtë

1/1. Në rastin e dhënies së pëlqimit të Kuvendit për dekretet e Presidentit të Republikës për emërim në Gjykatën Kushtetuese ose në Gjykatën e Lartë votimi është nominal.

1. Votimi i fshehtë bëhet për çështje që kanë të bëjnë me personat.

2. Votimi i fshehtë, përveç rasteve kur nuk lejohet të kryhet sipas Kushtetutës, ligjit ose kësaj Rregulloreje, mund të kërkohet nga të paktën 7 deputetë dhe vendoset me votim nga Kuvendi. Kërkesa për votim të fshehtë duhet të formulohet në kohën që drejtuesi i seancës mbyll diskutimet, deklaron se do të kalohet në votim dhe përpara se të ketë ftuar deputetët të votojnë me ngritjen e dorës ose nëpërmjet mjeteve elektronike.

3. Votimi i fshehtë bëhet duke hedhur në kutinë e votimit fletën e votimit ose në mënyrë elektronike. Kur kërkohet me shkrim, nga të paktën $\frac{1}{4}$ e të gjithë deputetëve, votimi i fshehtë bëhet me fletë votimi.

3.1 Kur votimi i fshehtë zhvillohet me fletë votimi, ngrihet komisioni i votimit, me përbërje sipas përfaqësimit politik në Kuvend, për aq sa është e mundur.

4. Fleta e votimit të fshehtë duhet të përmbajë të paktën objektin e votimit dhe alternativat e votimit pro, kundër dhe abstenim. Në fletën e votimit deputeti shënon me një shenjë të dallueshme dhe të qartë për zgjedhjen e bërë në alternativën për të cilën është dakord. Në rast se fleta e votimit përmban më shumë se një kandidat, përbri emrave të tyre vendoset një kuadrat, në të cilën deputeti duhet të vendosë shenjën për zgjedhjen e bërë.

5. Zgjedhja e Presidentit të Republikës bëhet sipas procedurës së parashikuar në nenin 109 të Rregullores.

Neni 61

Përsëritja dhe shpallja e rezultatit të votimit

1. Çdo votim i kryer në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin ose Rregulloren e Kuvendit është i pavlefshëm. Drejtuesi i seancës, pasi merr mendimin e Sekretariatit për Procedurat dhe Votimet, urdhëron anulimin e votimit dhe përsëritjen menjëherë të tij.
2. Rezultati i votimit në seancë plenare shpallet nga drejtuesi i seancës, duke përdorur togfjalëshin “Miratohet nga Kuvendi” ose “Nuk miratohet nga Kuvendi”.

KREU IX

RREGULLI DHE SJELLJA NË KUVEND

Neni 62

Rregulli dhe sjellja në Kuvend

Anëtarët e Kuvendit nuk duhet të ndërpresin fjalën e drejtuesit të seancës plenare ose të diskutuesve të tjerë, të përdorin gjuhë ofenduese dhe joparlamentare në Kuvend, të ndërmarrin sulme personale apo veprime ndaj ndonjë deputeti, të përhapin informacione që cenojnë jetën private të cilitdo, të sillen në mënyrë të padenjë ose të shkaktojnë rrëmujë në mjediset e Kuvendit.

Neni 63

Masat disiplinore

(ndryshuar shkronja ç) me vendimin nr. 41/2013)

Masat disiplinore që zbatohen ndaj deputetëve janë:

- a) tërheqje vëmendjeje;
- b) vërejtje;
- c) përjashtim nga seanca plenare;
- ç) përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare deri në 10 ditë.”

Neni 64

Masa disiplinore e tërheqjes së vëmendjes dhe vërejtjes (shtuar pika 5 me vendimin e Kuvendit nr. 88, datë 24.2.2011)

1. Kur deputeti thotë fjalë të pahijshme, pengon me sjelljen e tij zhvillimin e seancës plenare ose cenon rregullin e saj, i tërhiqet vëmendja nga drejtuesi i seancës plenare.
2. Në rast se deputeti, ndaj të cilit është zbatuar masa disiplinore e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, kërkon të japë shpjegime për veprimet e tij ose gjuhën e përdorur, fjala i jepet në përfundim të seancës plenare të asaj dite për jo më shumë se 2 minuta.
3. Kur deputeti e përsërit shkeljen në të njëjtën seancë plenare, pasi i është tërhequr një herë më parë vëmendja, ose deputeti që cenon seriozisht rendin në seancë plenare i jepet vërejtje nga drejtuesi i seancës. Masa disiplinore e vërejtjes jepet nga drejtuesi i seancës për deputetin që përdor për votim kartën e votimit të një deputeti tjetër. Vërejtja regjistrohet në procesverbalin e përmbledhur të seancës plenare dhe bëhet publike.
4. Në rast se shprehjet ose fyerjet e bëra nga deputeti në seancë plenare tërhiqen prej tij në po të njëjtën seancë dhe deputeti kërkon publikisht ndjesë për sjelljen e tij, masa disiplinore e dhënë në zbatim të pikës 3 të këtij neni anulohet nga drejtuesi i seancës.
5. Kur deputeti pengon zhvillimin e rregullt të seancës, nëpërmjet zaptimit të foltores dhe moslejimit të deputetit të radhës të marrë fjalën, për më shumë se 2 minuta, atëherë Kryetari i Kuvendit i tërheq vërejtjen dhe e paralajmëron për marrjen e masës së përjashtimit në rast vazhdimi.

Në rast se deputeti vazhdon të mbajë të zaptuar foltoeren edhe pas tërheqjes së vërejtjes, për më shumë se një minutë, përjashtohet nga seanca plenare dhe komisionet me maksimumin e parashikuar në nenin 65 të Rregullores.

Neni 65
Masat disiplinore më të rënda
(ndryshuar pika 2 me vendimin nr. 41/2013)

1. Kur deputeti përdor fjalë fyese ose cenon personalitetin e drejtuesit të seancës apo vazhdon të kryejë shkeljen, pasi më parë në të njëjtën seancë janë zbatuar masat disiplinore, sipas nenit 64 të kësaj Rregulloreje, me urdhër të drejtuesit të seancës, përjashtohet nga seanca plenare për atë ditë. Në rast se deputeti s'pranon të dalë nga salla, drejtuesi i seancës e ndërpret atë dhe i jep porositë e nevojshme Shërbimit të Sigurisë në Kuvend për zbatimin e urdhrit të dhënë.

Masa disiplinore e përjashtimit nga seanca plenare shoqërohet me sanksion financiar të barabartë me një ditë nga paga e deputetit.

2. Kur deputeti bën thirrje për përdorim dhune, provokon rrëmujë në seancë që pengon zhvillimin e saj të rregullt, fyen ose kërcënon deputetët e tjerë, anëtarët e Këshillit të Ministrave ose përdor fjalë fyese për Presidentin e Republikës apo institucione të tjera shtetërore ndalohet të marrë pjesë në punimet e Kuvendit në seancë plenare dhe në komisione deri në 10 ditë.

Ndalimi i pjesëmarrjes vendoset nga Byroja e Kuvendit me propozimin e drejtuesit të seancës ose propozimit me shkrim të jo më pak se 7 deputetëve. Mbledhja e Byrosë së Kuvendit zhvillohet brenda 48 orëve dhe deputeti, ndaj të cilit kërkohet marrja e masës disiplinore, ka të drejtë të marrë pjesë në të për të paraqitur qëndrimin e tij.

Masa disiplinore e ndalimit të pjesëmarrjes në seancë plenare dhe në komisione shoqërohet me sanksion financiar të mbajtjes së pagës së deputetit për aq ditë sa është marrë masa disiplinore.

Në rast se deputeti përpiket të hyjë në sallën e seancës plenare ose të komisioneve përpara mbarimit të kësaj mase ndërkimore, afati i masës dyfishohet.

3. Për ngjarje tepër të rënda që ndodhin jashtë sallës ku zhvillohen punimet e Kuvendit, por brenda mjediseve të tij, Kryetari i Kuvendit merr masën disiplinore të parashikuar në pikën 2 të këtij neni.

Neni 66

Pezullimi dhe mbyllja e seancës plenare

Në rast se në sallë bëhet rrëmujë dhe nuk merren parasysh kërkesat e drejtuesit të seancës për mbajtjen e rregullit, drejtuesi i seancës lë vendin e tij dhe seanca plenare quhet e ndërprerë. Në rast se përsëri rrëmujaja vazhdon, drejtuesi i seancës e pezullon seancën për një periudhë kohe të caktuar ose e mbyll atë. Në rast të mbylljes së seancës, Kuvendi mblidhet me të njëjtin rend dite të nesërmen, nëse nuk është ditë pushimi.

Neni 67

Paraqitja në seancë plenare dhe në komisione

Deputetët, gjatë zhvillimit të mbledhjeve të komisioneve dhe të seancës plenare, paraqiten me veshje zyrtare dhe nuk duhet të përdorin telefonat e lëvizshëm.

PJESA E DYTË

PROCEDURA LIGJVËNËSE

KREU I

NISMA LIGJVËNËSE

Neni 68

Propozimi i ligjeve

1. E drejta për të propozuar ligje i takon Këshillit të Ministrave, çdo deputeti dhe 20 mijë zgjedhësve.
2. Projektligjet duhet të jenë të hartuara në formën e një akti normativ dhe të jenë të shoqëruara me një relacion, i cili duhet të përmbajë objektivat që synohen të arrihen me miratimin e tij, argumentet se këta objektiva nuk mund të arrihen me instrumentet ligjore ekzistuese, përputhshmërinë e projektligjit me Kushtetutën, harmonizimin me legjislacionin në fuqi dhe legjislacionin e Bashkimit Europian, si dhe efektet e tij sociale dhe ekonomike. Për projektligjet me karakter financiar, relacioni duhet të përmbajë edhe efektet e pritshme financiare që rrjedhin nga zbatimi i tij.
3. Asnjë projektligj joqeveritar, që rrit shpenzimet e Buxhetit të Shtetit ose pakëson të ardhurat e tij, nuk mund të miratohet pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së projektligjit. Në qoftë se Këshilli i Ministrave nuk shprehet brenda këtij afati, projektligji kalon për shqyrtim sipas procedurës së zakonshme.
4. Kryetari i Kuvendit, në mënyrë të arsyetuar, mund të kthejë te nismëtari projektligjet e depozituara, në rast se nuk përmbushin kërkesat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

Neni 69

Shpërndarja e projektligjeve

1. Projektligjet, pasi regjistrohen sipas rendit të paraqitjes së tyre në një regjistër të veçantë, i kalohen Kryetarit të Kuvendit.
2. Kryetari i Kuvendit urdhëron menjëherë shpërndarjen e tyre deputetëve. Kopje të projektligjeve u vihen në dispozicion, me kërkesën e tyre, medias ose personave të tjerë.
3. Projektligjet nuk mund të futen në kalendarin e punimeve të Kuvendit pa kaluar të paktën dy javë nga data e paraqitjes së tyre,

me përjashtim të rasteve kur në këtë Rregullore përcaktohet ndryshe. Projektligjet e paraqitura nga deputetët vihen në rendin e ditës të seancës plenare jo më vonë se 8 javë nga data e paraqitjes së projektligjit.

Neni 70

Raporti i komisionit përgjegjës dhe mendimet e komisioneve të tjera

1. Në përputhje me programin e punës dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit, Kryetari i Kuvendit i dërgon për shqyrtim projektligjet në komisionin përgjegjës dhe në komisionet që sipas kësaj Rregulloreje duhet të paraqesin mendimin e tyre.
2. Komisionet shqyrtojnë projektligjin në mënyrën e parashikuar në nenet 32-38 të kësaj Rregulloreje.
3. Pas shqyrtimit të projektligjit, komisioni përgjegjës harton një raport për në seancë plenare duke bërë propozimin për miratimin e tij siç është paraqitur, miratimin me ndryshime ose rrëzimin e projektligjit.
4. Raporti i komisionit përgjegjës dhe mendimet e komisioneve të tjera ose i Këshillit për Legjislacionin shumëfishohen dhe u shpëndahen deputetëve dhe Këshillit të Ministrave të paktën 2 ditë përpara datës së shqyrtimit të projektligjit në seancë plenare.

Neni 71

Propozimi i amendamenteve

Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të propozojë amendamente me shkrim të arsyetuara, të cilat paraqiten gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionin përgjegjës. Përfundimet e komisionit në lidhje me to i paraqiten seancës plenare në raportin që harton komisioni përgjegjës.

Neni 72
Tërheqja e nismës

Nismëtari i projektligjit ose i projektvendimit mund ta tërheqë projektin e tij deri në çastin kur ai nuk është votuar në parim në seancë plenare.

KREU II
SHQYRTIMI NË SEANCË PLENARE

Neni 73
Shqyrtimi në seancë plenare

1. Shqyrtimi i projektligjit në seancë plenare përfshin diskutimin në parim për projektligjin dhe shqyrtimin nen për nen të tij.
2. Para fillimit të diskutimit në parim deputetët ftohen nga drejtuesi i seancës t'i drejtojnë pyetje nismëtarëve ose anëtarëve të Këshillit të Ministrave që kanë lidhje me projektligjin. Në seancë plenare projektligji shqyrtohet në praninë e ministrit kundërfirmues të tij në Këshillin e Ministrave dhe të nëpunësve të autorizuar me shkrim nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.
3. Diskutimi në parim për projektligjin zhvillohet si në rastin kur komisioni përgjegjës ose Këshilli për Legjislacionin janë shprehur për miratimin e tij në parim, ashtu edhe në rastin kur janë shprehur për mosmiratimin e tij. Në rastin kur komisioni përgjegjës ose Këshilli për Legjislacionin janë shprehur për mosmiratimin në parim dhe Kuvendi në seancë plenare vendos miratimin e tij, projektligji kthehet në komisionin përgjegjës për vazhdimin e shqyrtimit të tij nen për nen.

4. Projektligji që nuk miratohet në parim në seancë plenare nuk mund të paraqitet përsëri pa kaluar 6 muaj nga data e mosmiratimit.

Neni 74

Diskutimi në parim

1. Diskutimi në parim për projektligjin fillon me paraqitjen nga nismëtari të arsyeve që kanë çuar në propozimin e projektligjit, si dhe me paraqitjen e raportit të komisionit përgjegjës dhe, sipas rastit, të Këshillit për Legjislacionin. Leximi i raportit bëhet nga kryetari i komisionit dhe mund t'i jepet fjala, me kërkesë të tij, edhe relatorit të projektligjit në komisionin përgjegjës për jo më shumë se 10 minuta.

2. Për diskutimin në parim drejtuesi i seancës u jep fjalën deputetëve që kanë kërkuar të diskutojnë, duke harmonizuar pjesëmarrjen për çdo grup parlamentar. Përpara mbylljes së diskutimit kanë të drejtë të flasin relatori i projektligjit në komisionin përgjegjës jo më shumë se 5 minuta dhe kryetarët e grupeve parlamentare, duke filluar nga grupi me numrin më të vogël të deputetëve.

3. Gjatë zhvillimit të diskutimit në parim nuk mund të paraqiten amendamente.

4. Drejtuesi i seancës, pas përfundimit të diskutimit në parim, deklaron kohën kur Kuvendi do të vendosë nëpërmjet votimit. Punimet e Kuvendit vijojnë me diskutimet në parim për projektligjet e tjera të rendit të ditës.

Neni 75

Shqyrtimi nen për nen

1. Projektligji shqyrtohet nen për nen pas miratimit të tij në parim.

2. Gjatë shqyrtimit nen për nen çdo deputet ka të drejtë të diskutojë për jo më shumë se 5 minuta. Kjo kohë dyfishohet në rastet e

diskutimit të projektligjeve që kërkojnë një shumicë të cilësuar për miratimin e tyre.

3. Gjatë shqyrtimit nen për nen mund të paraqiten amendamente të bëra me shkrim. Çdo amendament duhet t'i referohet përmbajtjes së një neni të vetëm. Si rregull, amendamentet duhet të paraqiten dhe të diskutohen fillimisht në komisionin përgjegjës. Autori i amendamentit ka të drejtë ta paraqesë atë në seancë plenare për jo më shumë se 7 minuta.

4. Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqesë në seancë plenare amendamente për projektligjin ose ndryshimet e propozuara nga komisioni përgjegjës, me kusht që ato të jenë regjistruar paraprakisht në sekretari të paktën 24 orë para fillimit të seancës plenare dhe t'u jenë shpërndarë deputetëve të tjerë.

5. Kur çmohet nga Kryetari i Kuvendit ose kur kërkohet nga kryetari i një grupi parlamentar apo nga një grup prej 10 deputetësh, amendamentet paraqiten për mendim në komisionin përgjegjës, duke pezulluar, në rast se është e nevojshme, edhe zhvillimin e seancës plenare. Në këtë rast autori i amendamentit dhe përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave kanë të drejtë të dëgjohen në mbledhjen e komisionit përgjegjës.

Neni 76

Radha e votimit të amendamenteve

1. Amendamentet hidhen në votim përpara tekstit të projektligjit.
2. Përpara votimit të çdo amendamenti, drejtuesi i seancës u rikujton deputetëve mendimin e komisionit përgjegjës për to.
3. Votimi i amendamenteve fillon me ata që kanë për qëllim ta heqin nenin; të heqin pjesë të tij; ta zëvendësojnë atë tërësisht dhe në fund për të shtuar ose ndryshuar fjalë të tij. Në rast se janë paraqitur dy ose më shumë amendamente për të njëjtin nen apo pjesë të tij, amendamenti që është më larg tekstit të projektligjit votohet i pari.

Kur komisioni përgjegjës ka paraqitur disa amendamente për një nen të projektligjit, drejtuesi i seancës i hedh ato në votim së bashku, me përjashtim të rastit kur të paktën 7 deputetë ose kryetari i një grupi parlamentar kërkojnë votimin e tyre të veçantë.

4. Kuvendi vendos me votim të veçantë për çdo amendament, me përjashtim të rastit kur miratimi i njërit përjashton të tjerët.

Neni 77 **Votimi në tërësi**

1. Në përfundim të shqyrtimit dhe votimit nen për nen, kalohet në votimin në tërësi të projektligjit.
2. Në rastin kur teksti i projektligjit, gjatë shqyrtimit në seancë plenare, ka pësuar ndryshime të rëndësishme, drejtuesi i seancës kryesisht ose me kërkesën e kryetarit të një grupi parlamentar apo të 7 deputetëve është i detyruar të shtyjë votimin në tërësi në seancën pasardhëse, duke i paraqitur Kuvendit tekstin e plotë të përpunuar.

KREU II/1 **(Shtuar kreu me Vendimin nr. 193, datë 7.7.2008)** **SHQYRTIMI I NISMAVE LIGJORE PËR RISHIKIMIN E** **KUSHTETUTËS**

Neni 77/a

1. Nisma për rishikimin e Kushtetutës mund të ndërmerret nga jo më pak se një e pesta e anëtarëve të Kuvendit. Kryetari i Kuvendit njofton Kuvendin në seancën plenare më të parë dhe u shpërndan deputetëve tekstin e projektligjit. Projektligji futet menjëherë në programin e punës së Kuvendit.
2. Projektligji shqyrtohet në mbledhjen e përbashkët të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

dhe Këshillit për Legjislacionin jo më parë se dy javë nga data e depozitimit. Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Kuvendit.

3. Në mbledhjen e parë caktohen jo më pak se dy relatorë. Mbledhja vendos për mënyrën e njohjes së projektit nga zgjedhësit, si dhe thirrjen e ekspertëve konstitucionalistë të fushës.

4. Mbledhjet për rishikimin e Kushtetutës dhe seancat dëgjimore bëhen të hapura për median dhe publikun.

5. Kur gjatë shqyrtimit të nismës së propozuar ka amendamente të reja, ato duhet të respektojnë kërkesat e nenit 177 pika 1 të Kushtetutës dhe përcaktimet e bëra në këtë nen.

6. Në përfundim të shqyrtimit, mbledhja e përbashkët e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Këshillit për Legjislacionin i paraqet seancës plenare raportin përkatës të hartuar nga relatorët, i cili përmban edhe mendimin e pakicës, kur ka të tillë.

Neni 77/b

1. Seanca plenare për miratimin e amendamenteve kushtetuese thirret jo më parë se dy javë dhe jo më vonë se tre javë nga paraqitja e raportit. Seanca e debatit zhvillohet e hapur dhe transmetohet drejtpërdrejt nga televizioni publik.

2. Shqyrtimi në seancë plenare fillon me diskutimin dhe votimin në parim, shqyrtimin dhe votimin nen për nen dhe përfundon me votimin në tërësi. Në seancë nuk mund të diskutohen amendamente të propozuara gjatë seancës plenare. Ato duhet të shqyrtohen më parë sipas nenit 77/a të Rregullores.

3. Votimi për miratimin e amendamenteve bëhet i hapur.

4. Amendamentet quhen të miratuara kur kanë votuar pro jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

KREU III

SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJIT TË BUXHETIT TË SHTETIT DHE I PROJEKTLIGJEVE FINANCIARE

Neni 78
Paraqitja e projektligjit të Buxhetit të Shtetit dhe
projektligjeve financiare

1. Kryetari i Kuvendit njofton menjëherë Kuvendin për paraqitjen e projektligjit të Buxhetit të Shtetit dhe të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.
2. Nëse projektligji i Buxhetit të Shtetit nuk paraqitet në afatin e përcaktuar ligjor, Kryetari i Kuvendit njofton Kuvendin.
3. Shqyrtimi i projektligjit të Buxhetit të Shtetit dhe i projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të, futen menjëherë në programin e punës së Kuvendit, i cili me këtë rast miraton një kalendar shqyrtimi të tyre të veçantë.

Neni 79
Kalendari i veçantë i shqyrtimit

1. Komisioni për Ekonominë dhe Financat është komisioni përgjegjës për shqyrtimin e projektligjit të Buxhetit të Shtetit dhe projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të. Për shqyrtimin e projektligjit të Buxhetit të Shtetit, Kryetari i Komisionit, sipas nenit 29 pika 2 të kësaj Rregulloreje, cakton relatorin kryesor që, si rregull, i caktohet në mënyrë të përhershme një deputeti që drejton të gjithë punën për përgatitjen e raportit të projektligjit të Buxhetit të Shtetit; për çështje të veçanta caktohen relatorë të veçantë.
2. Kryetari i Komisionit për Ekonominë dhe Financat, në bashkëpunim me relatorin kryesor, Zëvendës-kryetarin dhe Sekretarin e Komisionit, i paraqesin Kryetarit të Kuvendit projektkalendarin e shqyrtimit të projektligjit të Buxhetit të Shtetit dhe projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare. Kryetari i Kuvendit, brenda 2 ditëve, thërret Konferencën e

Kryetarëve, në të cilën paraqitet fillimisht nga Ministri i Financave projektligji i Buxhetit të Shtetit dhe projektligjet financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të dhe vendoset për kalendarin e punimeve në komisionet e përhershme dhe në seancë plenare. Në rast se kalendari miratohet me mirëkuptim, ai i njoftohet seancës plenare; në të kundërt Kryetari e paraqet atë për votim në seancën më të parë plenare të Kuvendit.

Neni 80

Shqyrtimi në komisione

(ndryshuar pikat 1 dhe 3 me vendimin nr. 41/2013)

1. Në përputhje me kalendarin e punimeve, sipas nenit 79 pika 2 të kësaj Rregulloreje, Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit, komisionet e përhershme, sipas fushave që mbulojnë, organizojnë punën për shqyrtimin e projektligjit të Buxhetit të Shtetit dhe të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të. Në mbledhjet e komisioneve marrin pjesë ministrat, relatori kryesor dhe, sipas rastit, relatorët e veçantë, të cilët bëjnë paraqitjen dhe japin shpjegimet përkatëse.
2. Komisionet e Kuvendit mund të organizojnë seanca dëgjimore publike me qëllim marrjen e vërejtjeve dhe mendimeve nga institucione, persona ose grupe të interesuara për projektligjin e Buxhetit të Shtetit dhe projektligjet financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.
3. Në përfundim të shqyrtimit Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit dhe komisionet hartojnë një raport vlerësimi për projektligjin e Buxhetit të Shtetit dhe projektligjet financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të. Raporti i dërgohet menjëherë Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

Neni 81

Shqyrtimi në parim në Komisionin për Ekonominë dhe Financat

1. Menjëherë pas miratimit të kalendarit, sipas nenit 79 pika 2 të kësaj Rregulloreje, Komisioni për Ekonominë dhe Financat fillon procedurën e shqyrtimit në parim të projektligjit të Buxhetit të Shtetit dhe të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.
2. Debati në parim në Komisionin për Ekonominë dhe Financat fillon me paraqitjen e projektligjit të Buxhetit të Shtetit dhe të projektligjeve financiare nga Ministri i Financave, me dëgjimin e relatorëve kryesorë dhe të relatorëve të veçantë e vijohet me diskutimet e përgjithshme dhe votimin në parim. Komisioni merr në shqyrtim raportet e paraqitura nga komisionet e tjera të përhershme të Kuvendit.
3. Në mbledhjen e Komisionit marrin pjesë kryetarët e komisioneve të përhershme që kanë paraqitur raporte, anëtarë të tjerë të komisioneve përkatëse, si dhe ministrat përkatës.
4. Pas përfundimit të diskutimeve dhe votimit në parim, Komisioni për Ekonominë dhe Financat i paraqet seancës plenare raportin e vlerësimit në parim të projektligjit të Buxhetit të Shtetit dhe të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të. Raporti përmban një vlerësim të plotë të strukturës së projektligjit të Buxhetit të Shtetit, si treguesit makroekonomikë, treguesit kryesorë, të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara, financimet dhe realizimin e tyre, sipas programit të Këshillit të Ministrave të miratuar në Kuvend, si dhe vlerësime për projektbuxhetet e institucioneve kushtetuese dhe të pavaruara.

Neni 82

Shqyrtimi në parim në seancë plenare

Kuvendi, në seancë plenare, pas paraqitjes së raportit të vlerësimit në parim të Komisionit për Ekonominë dhe Financat, diskuton dhe vendos për miratimin në parim të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me buxhetin dhe më vonë të projektligjit të Buxhetit të Shtetit, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 73 dhe 74 të kësaj Rregulloreje.

Neni 83

Shqyrtimi nen për nen në Komisionin për Ekonominë dhe Financat

(Ndryshuar pikat 1 dhe 2 me vendimin nr. 41/2013)

1. Me miratimin në parim të projektligjit të Buxhetit të Shtetit dhe projektligjeve financiare Komisioni për Ekonominë dhe Financat fillon diskutimin e tyre nen për nen, duke mbajtur parasysh edhe problematikën e trajtuar Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit dhe nga komisionet e përhershme ose nga Kuvendi në seancë plenare.

2. Gjatë shqyrtimit të tyre, pas fjalës së relatorit kryesor dhe relatorit të veçantë, u jepet fjala përfaqësuesve të Sekretariatit për Buxhetin e Kuvendit dhe të komisioneve të përhershme ose deputetëve që kanë paraqitur amendamente. Komisioni i shqyrton dhe vendos për to, sipas procedurës së parashikuar në nenet 32-38 të kësaj Rregulloreje. Komisioni fillimisht voton projektligjet financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me Buxhetin e Shtetit dhe vijon me amendamentet për të ardhurat, amendamentet për shpenzimet dhe projektligjin nen për nen.

Neni 84

Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi në seancë plenare

1. Pas paraqitjes së raportit për shqyrtimin nen për nen të Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Kuvendi në seancë plenare fillon shqyrtimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me buxhetin dhe të projektligjit të Buxhetit të Shtetit.
2. Gjatë shqyrtimit nen për nen kanë të drejtë të marrin fjalën relatori kryesor dhe relatorët e veçantë për jo më shumë se 10 minuta. Autorët e amendamenteve të rrëzuara në Komision kanë të drejtë të paraqesin propozimet e tyre për jo më shumë se 5 minuta.
3. Votimi nen për nen dhe në tërësi kryhet sipas rregullave të përcaktuara në nenet 75-77 të kësaj Rregulloreje.

Neni 85

Ndryshimet në Buxhetin e Shtetit dhe në ligjet financiare

Rregullat e përcaktuara në këtë Kre zbatohen edhe në rastin e ndryshimeve gjatë vitit të ligjit të Buxhetit të Shtetit ose të ligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.

KREU IV PROCEDURA TË VEÇANTA

Neni 86

Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji

1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht.

2. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës dhe brenda 8 javëve nga data e fillimit të shqyrtimit paraqet raportin e tij. Ky raport përmban mendimin e komisionit dhe, sipas rastit, edhe propozime për nene të veçanta të ligjit.

Neni 87

Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren në shqyrtim nga Këshilli për Legjislacionin menjëherë pas botimit të tyre në Fletoren Zyrtare.

2. Këshilli analizon dhe diskuton, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Rregullore, efektet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për legjislacionin. Nëse Këshilli vendos se nevojitet marrja e nismës ligjvënëse për plotësime ose ndryshime në legjislacion, ai i paraqet Këshillit të Ministrave rekomandimet e nevojshme ose ndërmerr nismën e vet ligjvënëse. Mendimi i Këshillit mund t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, Këshillit të Ministrave dhe Presidentit të Republikës.

Neni 88

Shqyrtimi i akteve të tjera normative

Procedurat e parashikuara në këtë pjesë zbatohen, për aq sa është e mundur, edhe për shqyrtimin e projektvendimeve normative që miratohen nga Kuvendi ose të akteve normative me fuqinë e ligjit të nxjerra nga Këshilli i Ministrave.

PJESA E TRETË KONTROLLI I KUVENDIT

KREU I

PYETJET, INTERPELANCAT DHE MOCIONET

Neni 89

Dispozitë e përbashkët

1. Shqyrtimi i pyetjeve, interpelancave dhe mocionet për zhvillimin e një debati bëhen veçmas nga çdo diskutim tjetër.
2. Kryetari i Kuvendit, pas këshillimit me Konferencën e Kryetarëve, mund të vendosë që pyetjet, interpelancat ose mocionet që lidhen me çështje të njëjta ose të ngjashme të grupohen së bashku dhe të shqyrtohen njëherësh. Kur deputetët kërkues nuk bien dakord me mendimin e Kryetarit, çështja i paraqitet Kuvendit në seancën plenare më të parë, i cili merr vendim me votim të hapur dhe pa debat.
3. Kryetari i Kuvendit ka të drejtë të mos pranojë pyetje, interpelanca ose mocione që janë formuluar me fjalë të pahijshme, paraqiten çështje që nuk janë nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, cenojnë nderin, jetën private ose personalitetin e një individi ose institucioni, janë në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit ose pyetje dhe interpelanca që janë konsumuar më parë apo mocione që janë diskutuar ose janë marrë vendime për të njëjtin motiv brenda sesionit. Kur deputeti nuk është në një mendje me mendimin e Kryetarit, çështja i shtrohet Kuvendit, i cili, pasi dëgjon mendimin e Kryetarit dhe të deputetit kërkues jo më shumë se 10 minuta, vendos me votim të hapur dhe pa debat.

Neni 90

Pyetjet

1. Çdo deputet ka të drejtë t'i bëjë pyetje Kryeministrit ose çdo anëtari tjetër të Këshillit të Ministrave. Deputetët ia paraqesin pyetjet Kryetarit të Kuvendit, i cili vë në dijeni anëtarin e Këshillit të Ministrave, të cilit i drejtohet pyetja.

2. Pyetjet bëhen për të marrë informacion për një ose disa çështje të caktuara. Pyetjet bëhen me shkrim, në një formë të qartë dhe të përmbledhur dhe duhet t'u përkasin atyre çështjeve që përfshihen në kompetencat e personave që u drejtohen pyetjet ose veprimtarisë së administratës për të cilën përgjigjen.

Neni 91

Përgjigjja e pyetjeve

1. Kuvendi njoftohet për pyetjet e bëra.
2. Kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe çdo anëtar tjetër i Këshillit të Ministrave është i detyruar t'u përgjigjet pyetjeve në seancë plenare brenda 3 javëve nga data e paraqitjes së tyre.
3. Në të njëjtën seancë plenare nuk mund të përfshihen më shumë se dy pyetje të bëra nga i njëjti deputet.

Neni 92

Zhvillimi i seancës së pyetjeve

1. Në çdo seancë plenare, pas përfundimit të diskutimeve për çështje që s'janë në rendin e ditës, sipas nenit 45 të kësaj Rregulloreje, të paktën 45 minuta duhet t'i kushtohen seancës së pyetjeve, me përjashtim të rastit kur në kalendarin e punimeve është përcaktuar ndryshe.
2. Në rast se tejkalohej koha e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, pyetjet, të cilave nuk u janë dhënë përgjigje, zhvillohen në seancën plenare pasardhëse.
3. Pas përgjigjes së pyetjes së bërë, deputeti ka të drejtë të marrë fjalën dhe të deklarojë nëse është i kënaqur ose jo me përgjigjen, për jo më shumë se 3 minuta për secilën pyetje.

Neni 93

Përgjigjet e pyetjeve në komision

1. Deputeti mund të kërkojë që përgjigjen e pyetjes ta marrë në komisionin e përhershëm. Në këtë rast Kryetari i Kuvendit ia kalon pyetjen, sipas objektit të saj, kryetarit të komisionit të përhershëm përkatës dhe lajmëron anëtarin e Këshillit të Ministrave, të cilit i është drejtuar pyetja.

2. Përgjigja e pyetjeve përbën pikën e parë të rendit të ditës të mbledhjes së komisionit të përhershëm me kalimin e 15 ditëve nga data e paraqitjes së saj dhe për zhvillimin e saj zbatohet neni 92 pika 3 e kësaj Rregulloreje.

Neni 94

Përgjigjet me shkrim të pyetjeve (Ndryshuar pika 1 me vendimin nr. 41/2013)

1. Në rast se deputeti kërkon përgjigje me shkrim, ai i drejtohet anëtarit përkatës të Këshillit të Ministrave, i cili duhet të përgjigjet brenda 3 javëve nga data e marrjes së kërkesës. Kërkesa e deputetit i përcillet brenda 2 ditëve institucionit përkatës.

2. Në rast se nuk jepet përgjigje brenda kohës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, Kryetari i Kuvendit, me kërkesën e pyetësit, përfshin dhënien e përgjigjes si pikë të parë të rendit të ditës të mbledhjes së komisionit të përhershëm që ka lidhje me objektin e pyetjes.

Neni 95

Seanca e përjavshme e pyetje-përgjigjeve

1. Një herë në javë, të mërkurave, zhvillohet seanca e përjavshme e pyetje- përgjigjeve jo më shumë se 60 minuta.

2. Pyetjet për seancën e përjavshme të pyetje-përgjigjeve paraqiten me shkrim deri ditën e hënë në orën 1400 në sekretarinë e Kuvendit. Pyetjet i paraqiten menjëherë Kryeministrit dhe anëtarit të Këshillit të Ministrave, të cilit i janë drejtuar.
3. Çdo deputet, në seancën e përjavshme të pyetje-përgjigjeve, ka të drejtë të paraqesë një pyetje të vetme, të formuluar qartë dhe në mënyrë të përmbledhur për një çështje urgjente ose me interes të gjerë publik ose politik.
4. Çdo deputet, që ka paraqitur pyetjen për seancën e përjavshme të pyetje-përgjigjeve, mund ta parashtrojë atë për një kohë jo më të gjatë se 2 minuta. Kryeministri ose ministri përgjigjet për pyetjen e bërë jo më shumë se 5 minuta dhe, pas kësaj, pyetësi ka përsëri të drejtën të flasë deri në 3 minuta. Pyetjeve fillimisht u përgjigjet Kryeministri ose Zëvendëskryeministri dhe më pas vijohet me ministrin, të cilit i janë drejtuar numri më i madh i pyetjeve.
5. Në rastet e pyetjeve për seancën e përjavshme të pyetje-përgjigjeve zbatohet neni 89 i kësaj Rregulloreje.
6. Pyetjet e paraqitura sipas këtij neni nuk mund të vendosen edhe si pyetje të zakonshme.

Neni 96

Interpelancat

1. Interpelancë është kërkesa me shkrim drejtuar Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit ose çdo anëtarit tjetër të Këshillit të Ministrave, për të marrë shpjegime për motivet, synimet dhe qëndrimin e Këshillit të Ministrave ose lidhur me aspekte të rëndësishme të veprimtarisë së tyre. Interpelanca i paraqitet Kryetarit të Kuvendit, i cili vë në dijeni menjëherë anëtarin e Këshillit të Ministrave, të cilit i drejtohet kërkesa për interpelancë.
2. Interpelanca bëhet nga çdo deputet ose grup deputetësh.
3. Interpelancat, me përjashtim të rasteve kur në këtë Rregullore parashikohet ndryshe, paraqiten në Kuvend çdo të martë deri në

orën 1400. Ato parashikohen të zhvillohen në seancë plenare, si rregull, në tri të hënat pasardhëse nga data e paraqitjes.

4. Nuk mund të zhvillohen në të njëjtën seancë plenare më shumë se dy interpelanca të paraqitura nga i njëjti deputet ose grup deputetësh.

5. Deputeti, që ka paraqitur interpelancën, ka të drejtë ta shpjegojë atë jo më shumë se 7 minuta dhe pas deklarimit jo më shumë se 20 minuta të anëtarit të Këshillit të Ministrave, të cilit i është drejtuar interpelanca, të shprehë për jo më shumë se 15 minuta arsyet nëse është i kënaqur ose jo me përgjigjen e dhënë. Pas përfundimit të fjalës së deputetit, ka të drejtë të flasë ministri dhe pas tij deputeti që ka paraqitur interpelancën për jo më shumë se 3 minuta secili.

Neni 97

Interpelancat për çështje urgjente

1. Një kryetar grupi parlamentar ose 7 deputetë mund të kërkojnë zhvillimin e një interpelance për çështje urgjente. Çdo kryetar grupi parlamentar nuk mund të kërkojë më shumë se një interpelancë për çështje urgjente për një muaj dhe çdo deputet nuk mund të nënshkruajë më shumë se një interpelancë të tillë për një muaj.

2. Interpelanca për çështje urgjente, si rregull, depozitohet në Kuvend jo më vonë se ditën e hënë në orën 1400 dhe ajo zhvillohet si pikë e parë e rendit të ditës në një nga seancat plenare të javës në vijim.

3. Për interpelancat për çështje urgjente zbatohet neni 96 pika 5 e kësaj Rregulloreje.

Neni 98

Mocionet

1. Një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 7 deputetë mund të paraqesin një mocion me qëllim zhvillimin e një debati në Kuvend për një çështje të veçantë dhe, në përfundim të tij, mund të propozojnë miratimin e një rezolute ose deklarate, teksti i së cilës i bashkëlidhet kërkesës për zhvillimin e mocionit.

2. Kërkesa për zhvillimin e një mocioni paraqitet te Kryetari i Kuvendit, i cili brenda 3 ditëve mbledh Konferencën e Kryetarëve për të vendosur për datën e zhvillimit të mocionit në seancë plenare. Në rast se data përcaktohet me mirëkuptim në Konferencën e Kryetarëve, ajo i njoftohet Kuvendit në seancën plenare më të parë. Në rast se në Konferencën e Kryetarëve nuk arrihet mirëkuptimi mes kryetarëve të grupeve parlamentare, Kryetari i Kuvendit e paraqet kërkesën në seancë plenare, propozon një datë të mbajtjes së mocionit dhe i kërkon Kuvendit të vendosë me votim të hapur pasi dëgjon një folës pro dhe një kundër për jo më shumë se 10 minuta. Në çdo rast debati nuk mund të zhvillohet më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së mocionit.

3. Kur ka disa mocione për çështje të njëjta ose që lidhen me njëra - tjetrën, Kuvendi mund të bëjë një debat të përbashkët.

Neni 99

Zhvillimi i mocionit në seancë plenare

1. Zhvillimi i mocionit në seancë plenare përfshin debatin e përgjithshëm dhe debatin për amendamentet për projektdeklaratën ose projektrezolutën, në rast se ajo është propozuar për miratim.

2. Koha e debatit të përgjithshëm përcaktohet në Konferencën e Kryetarëve, në përputhje me nenin 48 pika 3 të kësaj Rregulloreje. Deputetët që dëshirojnë të diskutojnë në debatin e përgjithshëm

duhet të jenë regjistruar në listën e diskutuesve të paktën dy orë para fillimit të debatit.

3. Amendamentet me shkrim për projektrezolutën ose projektdeklaratën duhet të jenë të regjistruara në Sekretariatën për Procedurat dhe Votimet të paktën 24 orë para kohës së caktuar për zhvillimin e debatit dhe t'u jenë shpërndarë deputetëve. Pas përfundimit të debatit të përgjithshëm, autori i amendamentit ka të drejtë të paraqesë propozimin e tij për jo më shumë se 5 minuta dhe çdo deputet ka të drejtë të diskutojë deri në 5 minuta për amendamentin e paraqitur.

4. Drejtuesi i seancës fillimisht hedh në votim amendamentet që kërkojnë të shtojnë ose të ndryshojnë fjalë në tekstin e projektdeklaratës ose të projektrezolutës, duke filluar nga amendamenti që është më larg tekstit, pastaj ato që kërkojnë të heqin fjalë ose pjesë të saj dhe në fund tekstin e paraqitur nga nismëtarët e mocionit.

KREU II MOCIONET E BESIMIT DHE TË MOSBESIMIT

Neni 100

(Ndryshuar pika 4, me vendimin nr. 193, datë 7.7.2008)

Mocioni i besimit

1. Kryeministri, në mbështetje të nenit 104 të Kushtetutës, mund të paraqesë në Kuvend mocion besimi. Mocioni i besimit paraqitet nga Kryeministri për një çështje që ai e vlerëson të rëndësishme dhe mund të lidhet me miratimin në Kuvend të një projektligji ose projektvendimi. Në rast se Kryeministri paraqet mocionin të lidhur me miratimin e një neni, pjesë të tij ose me projektligjin në tërësi, mocioni votohet pasi të jenë paraqitur të gjitha amendamentet në

lidhje me ta. Teksti i propozuar nga Kryeministri hidhet i pari në votim.

2. Mocioni i besimit nuk mund të lidhet me propozime për hetime të Kuvendit, emërime dhe shkarkime personash, heqje imuniteti dhe në përgjithësi me çështje që lidhen me funksionimin e Kuvendit.

3. Konferenca e Kryetarëve përcakton kohën e debatit që do të mbahet për mocionin e besimit, duke i lejuar kohë për diskutime jo më pak se 3 minuta çdo deputeti që s'bën pjesë në grup parlamentar ose atyre që dëshirojnë të paraqesin qëndrime të ndryshme nga grupi parlamentar të cilit i përkasin. Votimi i mocionit nuk mund të bëhet pa kaluar 3 ditë nga data e paraqitjes së tij në seancë plenare.

4. Në rast se mocioni i besimit votohet nga më pak se gjysma e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, Kryeministri, brenda 48 orëve nga votimi i mocionit, i kërkon Presidentit të Republikës shpërndarjen e Kuvendit. Presidenti shpërndan Kuvendin brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës. Kërkesa për mocion besimi nuk mund të paraqitet gjatë periudhës së shqyrtimit të mocionit të mosbesimit, sipas nenit 105 të Kushtetutës.

Neni 101

(Ndryshuar pikat 1 dhe 4, me vendimin nr. 193, datë 7.7.2008)

Mocioni i mosbesimit

1. Jo më pak se një e pesta e të gjithë deputetëve, në mbështetje të nenit 105 të Kushtetutës, ka të drejtë të paraqesë për votim në Kuvend mocion mosbesimi ndaj Kryeministrit në detyrë, duke propozuar njëkohësisht një Kryeministër të ri. Mocioni i mosbesimit duhet të përmbajë nënshkrimet e deputetëve dhe të jetë i arsyetuar.

2. Me paraqitjen e mocionit të mosbesimit, Kryetari i Kuvendit njofton menjëherë Kryeministrin dhe thërret Konferencën e

Kryetarëve, për të përcaktuar datën e zhvillimit të mocionit. Paraqitja e mocionit në seancë plenare bëhet jo më vonë se 7 ditë nga depozitimi i tij dhe votimi nuk mund të bëhet pa kaluar 3 ditë nga paraqitja e tij në seancë plenare, sipas pikës 3 të këtij neni.

3. Seanca plenare, e përcaktuar për zhvillimin e mocionit të mosbesimit, fillon me paraqitjen e mocionit për jo më shumë se 5 minuta nga përfaqësuesi i nënshkruesve të tij dhe vijon me zhvillimin e debatit për të, sipas kohës së përcaktuar në Konferencën e Kryetarëve. Në përfundim të debatit ka të drejtë të flasë përfaqësuesi i nënshkruesve të mocionit jo më shumë se 10 minuta.

4. Kuvendi mund të votojë një mocion mosbesimi ndaj Kryeministrit vetëm duke zgjedhur me votat e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij një Kryeministër të ri. Presidenti i Republikës dekreton shkarkimin e Kryeministrit në detyrë dhe emërimin e Kryeministrit të zgjedhur jo më vonë se 10 ditë nga data e votimit të mocionit të mosbesimit në Kuvend.

5. Në rastin kur mocioni i mosbesimit nuk miratohet, nënshkruesit e tij nuk mund të paraqesin dhe as t'i bashkohen ndonjë mocioni tjetër mosbesimi brenda të njëjtit sesion.

KREU III

DISPOZITA TË TJERA PËR KONTROLLIN

NGA KUVENDI

Neni 102

Kontrolli nga komisionet e përhershme të Kuvendit

1. Komisionet e përhershme të Kuvendit mund t'i paraqesin Kuvendit raporte ose propozime për çështje që janë nën kompetencën e tyre ose kur një gjë e tillë u është kërkuar nga Kuvendi.

2. Komisionet kanë të drejtë të thërrasin në çdo kohë ministrat, për të dhënë shpjegime dhe sqarime për probleme të fushave ku ata

janë individualisht përgjegjës, si dhe për zbatimin e ligjeve, të vendimeve, rezolutave ose deklaratave të miratuara nga Kuvendi. Drejtuesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve, japin shpjegime dhe informojnë për çështje që lidhen me veprimtarinë e tyre.

3. Komisionet e përhershme, brenda fushave përkatëse të përgjegjësisë, mund të kryejnë kontrole ose të kërkojnë dokumentacione që i konsiderojnë të nevojshme për shqyrtimin e një çështjeje të caktuar. Në këtë rast Kryetari i Kuvendit njoftohet me shkrim nga kryetari i komisionit. Në përfundim të kontrollit, komisionet hartojnë një raport, i cili i përcillet Kryetarit të Kuvendit dhe bëhet i njohur publikisht, duke përfshirë edhe mendimin e pakicës.

Neni 103

Raportimi në Kuvend

1. Konferenca e Kryetarëve, në fillim të çdo viti, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, vendos për kalendarin e paraqitjes në Kuvend të raporteve të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj. Kalendari i paraqitjes së raporteve u shpërndahet deputetëve në seancën plenare më të parë.

2. Kryetari i Kuvendit u kërkon dërgimin me shkrim të raportit institucioneve përkatëse të paktën dy javë para datës së caktuar për t'u mbajtur në seancë plenare dhe, pas paraqitjes së tyre, ia dërgon menjëherë komisionit të përhershëm përkatës për shqyrtim. Komisioni organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit dhe, në përfundim të diskutimeve, harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit dhe ia paraqet atë seancës plenare.

3. Në seancë plenare, raporti mbahet nga titullari i institucionit për jo më shumë se 60 minuta, lexohet projektrezoluta e komisionit përkatës për vlerësimin e punës së institucionit dhe vijohet me pyetjet dhe përgjigjet e tyre dhe hapjen nga drejtuesi i seancës i debatit, në rast se zhvillimi i debatit kërkohet me shkrim nga një

komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë. Koha e debatit përcaktohet nga Konferenca e Kryetarëve, në përputhje me nenin 48 pika 3 e kësaj Rregulloreje. Në përfundim të debatit votohet projektrezoluta e paraqitur nga komisioni, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 99 të kësaj Rregulloreje.

4. Një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë kanë të drejtë të kërkojnë të thirren në seancë plenare drejtuesit e institucioneve shtetërore, për të dhënë shpjegime ose për të informuar Kuvendin për çështje të veprimtarisë së tyre. Kërkesa duhet të paraqitet me shkrim dhe Kuvendi vendos me votim të hapur dhe pa debat, pasi dëgjon një folës pro dhe një kundër jo më shumë se 3 minuta.

Neni 104 **Peticionet**

1. Peticionet, të cilat i drejtohen Kuvendit, shqyrtohen nga komisionet e përhershme përkatëse.

2. Pranohen për shqyrtim petitionet, të cilat janë bërë me shkrim, kanë emrin e dërguesit dhe nënshkrimet përkatëse, janë të kuptueshme dhe tregojnë qartë objektin e tyre.

3. Peticionet dërgohen nga Kryetari i Kuvendit në komisionin e përhershëm që ka lidhje me objektin e paraqitur në petition. Kryetari komisionit mund t'ia kthejë petitionin dërguesve për rihartim ose t'u kërkojë atyre sqarime shtesë.

4. Jo më vonë se 45 ditë nga data e marrjes së petitionit, kryetari i komisionit e paraqet petitionin në komision, duke propozuar njëkohësisht edhe mënyrën e zgjidhjes ligjore ose mospranimin e petitionit. Në rast se komisioni e gzykon të arsyeshme për zgjidhjen e çështjes, mund të autorizojë kryetarin e komisionit për të paraqitur një deklaratë në seancën plenare të Kuvendit. Hapat e ndërmarrë dhe zgjidhja e çështjes së ngritur në petition i njoftohen dërguesve të petitionit.

PJESA E KATËRT
TRANSPARENCA E VEPRIMTARISË SË KUVENDIT

Neni 105

Veprimtaria e hapur e Kuvendit
(Shtuar pika 2/1 me vendimin nr. 41/2013)

1. Veprimtaria e Kuvendit është e hapur, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 43 të kësaj Rregulloreje.

2. Veprimtaria e hapur e Kuvendit realizohet nëpërmjet:

- a) pjesëmarrjes së publikut në procesin ligjvënës;
- b) pasqyrimit të veprimtarisë së Kuvendit dhe organeve të tij në median e shkruar dhe vizive;
- c) botimeve të dokumentacionit parlamentar;
- ç) faqes së internetit të Kuvendit;
- d) rrjetit të brendshëm audiovizual.

2/1. Faqja e internetit e Kuvendit, për procedurën ligjvënëse, në mënyrë të përditësuar përmban:

- a) tekstin e projektligjeve të depozituara, së bashku me relacionin shoqërues të tyre;

- b) kalendarin e punës së komisioneve të përhershme dhe ecurinë e shqyrtimit të projektligjeve;

- c) procesverbalet e mbledhjeve të Konferencës së Kryetarëve, të komisioneve dhe të këshillave;

- ç) tekstin e amendamenteve të depozituara në komisione dhe të amendamenteve të miratuara prej tyre;

- d) raportet e komisioneve parlamentare, të cilat shqyrtojnë projektligjin.

3. Për realizimin e veprimtarisë së hapur në Kuvend organizohen shërbimet e specializuara të informacionit dhe të dokumentacionit parlamentar. Byroja e Kuvendit miraton rregullore të veçanta për funksionimin e tyre.

4. Përfaqësuesit e mediave që pasqyrojnë veprimtarinë e Kuvendit akreditohen pranë Kuvendit, sipas një procedure të veçantë të miratuar nga Byroja e Kuvendit.

Neni 106
Dokumentacioni parlamentar
(Shtuar pika 1/1 me vendimin nr. 41/2013)

1. Dokumentacioni parlamentar përfshin:

- a) ligjet, vendimet, rezolutat, deklaratat e Kuvendit dhe projektet e tyre;
- b) dokumentet që lidhen me ushtrimin e funksioneve të Kryetarit të Kuvendit;
- c) dokumentet që lidhen me përgatitjen dhe zhvillimin e seancave plenare të Kuvendit;
- ç) dokumentet që lidhen me përgatitjen dhe zhvillimin e mbledhjeve të komisioneve të Kuvendit;
- d) dokumentet që lidhen me veprimtarinë e organeve të Kuvendit;
- dh) botimet parlamentare të Kuvendit;
- e) prodhimet audiovizuale që lidhen me veprimtarinë e Kuvendit.

1/1. Dokumentacioni parlamentar mbahet edhe në një regjistër elektronik. Dokumentet parlamentare dhe dokumente të tjera të këtij regjistri, në përputhje me legjislacionin në fuqi, janë drejtpërdrejt të aksesueshme nga publiku në faqen e internetit të Kuvendit.

Byroja e Kuvendit përcakton modalitetet e zbatimit të kësaj pike

2. Dokumentacioni parlamentar është i hapur për publikun.

3. Dokumentacioni parlamentar dhe fondi historik i Kuvendit ruhen në Arkivin e Dokumentacionit Parlamentar. Sistemimi, klasifikimi dhe procedurat e përdorimit të dokumentacionit parlamentar dhe të fondit historik përcaktohen me rregullore të veçantë të miratuar nga Byroja e Kuvendit.

Neni 107

Botimet parlamentare

1. Botimet parlamentare përfshijnë:

- a) procesverbalet e seancave plenare të Kuvendit;
- b) procesverbalet e përmbledhura të mbledhjeve të komisioneve të Kuvendit dhe të seancave plenare, përkatësisht sipas neneve 39 dhe 54 të kësaj Rregulloreje;
- c) ligjet, vendimet, rezolutat dhe deklaratat e miratuara nga Kuvendi;
- ç) paraqitjen e veprimtarisë së Kuvendit dhe të organeve të tij;
- d) raportin vjetor të veprimtarisë së Kuvendit;
- dh) publikimet e paraqitura në faqen e internetit të Kuvendit.

2. Byroja e Kuvendit ka autoritetin e vendimmarrjes për botimet parlamentare.

Neni 108

Transmetimi nga Televizioni Publik Shqiptar

1. Miratimi i programit politik dhe i përbërjes së Këshillit të Ministrave, seancat e pyetjeve, seanca e përjavshme e pyetje-përgjigjeve, interpelancat, interpelancat urgjente, mocionet, mocionet e besimit dhe të mosbesimit, si dhe raportet e komisioneve hetimore transmetohen të plota nga Televizioni Publik Shqiptar.

2. Me kërkesën e Konferencës së Kryetarëve, Televizioni Publik Shqiptar transmeton në orët e shikimit më të shumtë edhe seanca të tjera plenare, për të cilat Konferenca e Kryetarëve ka vlerësuar, duke e përcaktuar në kalendarin e punimeve të Kuvendit, se duhet bërë transmetimi i tyre i plotë.

PJESA E PESTË EMËRIMI, ZGJEDHJA DHE SHKARKIMI I ORGANEVE

Neni 109

**(Ndryshuar pikat 3 dhe 4, me vendimin e Kuvendit nr. 193,
datë 7.7.2008)**

Zgjedhja e Presidentit të Republikës

1. Presidenti i Republikës zgjidhet në përputhje me nenet 86, 87 dhe 88 të Kushtetutës, me votim të fshehtë dhe pa debat. Konferenca e Kryetarëve cakton datën e kryerjes së votimit për çdo raund votimi të përcaktuar në Kushtetutë. Sekretariati për Procedurat dhe Votimet është komisioni i votimit, i cili në këtë rast organizon dhe shpall publikisht rezultatin e votimit.

2. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut shqyrton nëse kandidatët për president i plotësojnë kushtet e përcaktuara në Kushtetutë dhe i paraqet raportin seancës plenare, sipas afatit të përcaktuar nga Konferenca e Kryetarëve.

3. Presidenti i Republikës zgjidhet me një shumicë prej jo më pak se tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit në votimin e parë, votimin e dytë ose votimin e tretë. Në votimin e katërt dhe në votimin e pestë zgjidhet President kandidati që siguron më shumë se gjysmën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Votimi quhet i kryer edhe kur në konkurrim nuk paraqitet asnjë kandidat.

Votimi i parë zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga fillimi i procedurës për zgjedhjen e Presidentit, sipas nenit 88 të Kushtetutës. Në rast se në votimin e parë nuk arrihet shumica prej tri të pestave të votave, Konferenca e Kryetarëve menjëherë cakton datën e kryerjes së votimit të dytë, i cili zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të parë. Për votimin e dytë dhe sipas pikës 2 të këtij neni mund të paraqiten kandidatë të rinj nga jo më pak se 20 deputetë, që s'kanë marrë pjesë në asnjë grup propozues

në votimin e parë, ose kur kandidati që ata propozuan në votimin e parë është tërhequr.

Në rast se në votimin e dytë nuk arrihet shumica prej tri të pestave të votave, Konferenca e Kryetarëve menjëherë cakton datën e kryerjes së votimit të tretë, i cili zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të dytë. Për votimin e tretë dhe sipas pikës 2 të këtij neni mund të paraqiten kandidatë të rinj nga jo më pak se 20 deputetë, që s'kanë marrë pjesë në asnjë grup propozues në votimin e parë ose të dytë, ose kur kandidati që ata propozuan në votimin e parë ose të dytë është tërhequr.

Në rast se në votimin e tretë nuk arrihet shumica prej tri të pestave të votave, Konferenca e Kryetarëve menjëherë cakton datën e votimit të katërt, i cili zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të tretë. Për votimin e katërt dhe sipas pikës 2 të këtij neni mund të paraqiten kandidatë të rinj nga jo më pak se 20 deputetë, që s'kanë marrë pjesë në asnjë grup propozues në votimet pararendëse, ose kur kandidati që ata propozuan në votimet pararendëse është tërhequr.

Në rast se në votimin e katërt nuk arrihet shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës, Konferenca e Kryetarëve cakton menjëherë datën e votimit të pestë, i cili zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të katërt. Votimi i pestë zhvillohet mes dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në votimin e katërt. Në rast se ka më shumë se dy kandidatë me të njëjtin numër votash, kandidati që merr pjesë në votimin e pestë caktohet me short.

Në rast se pas votimit të katërt nuk ka mbetur asnjë kandidat për konkurrim, për këtë votim mund të paraqiten kandidatë të rinj, sipas kushteve të pikës 1 të nenit 87 të Kushtetutës dhe pikës 2 të këtij neni. Kur paraqiten më shumë se dy kandidatë, votimi i pestë zhvillohet mes dy kandidatëve që kanë siguruar numrin më të madh të deputetëve propozues.

4. Në rast se edhe në votimin e pestë asnjë kandidat nuk siguron shumicën e kërkuar, ose kur pas votimit të katërt pa sukses nuk paraqitet asnjë kandidaturë e re, Kryetari i Kuvendit shpall

shpërndarjen e Kuvendit. Kuvendi pasardhës zgjedh Presidentin e Republikës me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 110

Miratimi i programit politik dhe i përbërjes së Këshillit të Ministrave

1. Data e seancës plenare për miratimin e programit politik dhe të përbërjes së Këshillit të Ministrave, në zbatim të nenit 97 të Kushtetutës, përcaktohet nga Kryetari i Kuvendit në marrëveshje me Kryeministrin.
2. Programi politik i Këshillit të Ministrave dhe përbërja e tij paraqiten në Kuvend nga Kryeministri.
3. Pas paraqitjes së programit politik, çdo deputet dhe grup parlamentar ka të drejtë të paraqesë pyetje për Kryeministrin.
4. Pas përgjigjeve të pyetjeve, Kryetari i Kuvendit deklaron hapjen e debatit për programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave. Koha e debatit përcaktohet nga Konferenca e Kryetarëve, në përputhje me nenin 48 të kësaj Rregulloreje. Në përfundim të debatit, pas fjalës së kryetarëve të grupeve parlamentare, ka të drejtë të flasë Kryeministri jo më shumë se 10 minuta. Votimi nga Kuvendi i përbërjes dhe i programit politik të Këshillit të Ministrave bëhet sipas nenit 58 të kësaj Rregulloreje.
5. Në rast se Kuvendi nuk miraton programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave, Kryetari i Kuvendit vë në dijeni menjëherë Presidentin e Republikës.
6. Në rastin e parashikuar në nenin 96 pika 3 të Kushtetutës, Kryetari i Kuvendit fton kryetarin e partisë ose të koalicionit të partive që kanë shumicën e vendeve në Kuvend që brenda 3 ditëve të propozojë Kryeministrin e ri. Propozimi për zgjedhjen e Kryeministrit të ri shqyrtohet nga Kuvendi në seancë plenare jo më vonë se 7 ditë nga data e propozimit.

Neni 111

(Ndryshuar pikat 3,4,5,6 dhe 8, me vendimin nr. 193, datë 7.7.2008, pika 6 me vendimin nr. 41, datë 24.06.2010 dhe pika 7 me vendimin nr. 41/2013)

Zgjedhja në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj dhe dhënia e pëlqimit

1. Kandidaturat për në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, të cilat zgjidhen nga Kuvendi, me përjashtim të rasteve kur nuk është parashikuar ndryshe në Kushtetutë ose në ligj, duhet të paraqiten me shkrim nga jo më pak se 28 deputetë dhe të përmbajnë një curriculum vitae të kandidatit dhe pëlqimin e tij për kandidimin.
2. Kandidaturat duhet të propozohen 45 deri në 30 ditë përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të organit dhe jo më vonë se 10 ditë pas shkarkimit të anëtarit të organit kushtetues apo të krijuar me ligj.
3. Me paraqitjen e kandidaturave, Kryetari i Kuvendit ia kalon ato menjëherë komisionit përkatës, i cili vendos nëse kandidaturat i plotësojnë kushtet ligjore brenda tre javëve nga marrja e kërkesës.
4. Kuvendi kryen votimin për kandidatët jo më vonë se 30 ditë nga mbarimi i mandatit ose nga data e shkarkimit.
5. Në rastet kur zgjedhja në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj bëhet nga Kuvendi, me propozim të institucioneve të tjera, procedohet sipas pikës 3 të këtij neni. Kuvendi shqyrton kërkesën në seancë plenare brenda një jave nga paraqitja e raportit të komisionit përkatës.
6. Në rastet kur në Kushtetutë parashikohet dhënia e pëlqimit nga Kuvendi, Kryetari i Kuvendit ia kalon kërkesën Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, i cili e shqyrton atë dhe harton raportin përkatës brenda 8 javëve. Kuvendi shqyrton kërkesën për dhënien e pëlqimit në seancë plenare brenda një jave nga data e paraqitjes së raportit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të

Drejtat e Njeriut dhe, nëse kërkohet nga të paktën një kryetar grupi parlamentar, zhvillohet debat për të.

7. Në të gjitha rastet, komisioni përkatës, brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, shqyrton përmbushjen e kriterëve kushtetuese e ligjore dhe meritën e çdo kandidature. Komisioni organizon seanca dëgjimore publike me secilin kandidat. Në rastin kur ka mangësi në dokumentacion për kandidaturën, komisioni i kërkon Kryetarit të Kuvendit të njoftojë institucionin propozues për plotësimin e tyre.

8. Kur asnjë nga kandidatët nuk merr shumicën e kërkuar të votave, procedura fillon me kandidatura të tjera nga e para, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe.

Neni 112

Shkarkimi dhe pamundësia në ushtrimin e detyrave të Presidentit të Republikës

1. Jo më pak se një e katërta e të gjithë anëtarëve të Kuvendit mund të propozojë shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës për shkaqet e parashikuara në nenin 90 pika 2 të Kushtetutës. Kërkesa duhet të paraqitet me shkrim te Kryetari i Kuvendit dhe të përmbajë në mënyrë të motivuar dhe konkrete shkeljen e rëndë të Kushtetutës ose kryerjen e një krimi të rëndë. Me paraqitjen e propozimit, Kryetari i Kuvendit vë menjëherë në dijeni Kuvendin dhe Presidentin e Republikës.

2. Kryetari i Kuvendit ia përcjell kërkesën dhe dokumentet shoqëruese të saj Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, i cili brenda 15 ditëve i paraqet Kuvendit raportin dhe propozimin e tij për ngritjen ose mosngritjen e një komisioni hetimor. Në rast se kërkohet nga Presidenti i Republikës për t'u shprehur në Komision, Komisioni është i detyruar ta dëgjojë atë, duke i lënë një kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe dhënien e sqarimeve.

3. Kuvendi zhvillon debat në seancë plenare jo më vonë se 7 ditë nga data e paraqitjes së raportit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe në përputhje me kohën e përcaktuar nga Konferenca e Kryetarëve, sipas nenit 48 të kësaj Rregulloreje. Në rast se Kuvendi rrëzon nëpërmjet votimit raportin dhe propozimin e paraqitur, procedura për shkarkimin e Presidentit të Republikës ndërpritet. Kuvendi për të njëjtin motiv nuk mund të vendosë përsëri edhe nëse kërkesa paraqitet nga një grup tjetër deputetësh. Në rast se Kuvendi pranon nëpërmjet votimit raportin dhe propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ngre brenda 2 ditëve një komision hetimor për këtë çështje. Komisioni hetimor është i detyruar të thërrasë dhe të dëgjojë mendimin e Presidentit të Republikës në lidhje me propozimin e paraqitur.

Në përfundim të hetimit, komisioni hetimor duhet t'i paraqesë Kuvendit në mënyrë të arsyetuar nëse ekzistojnë shkaqet për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

4. Kuvendi shqyrton raportin e komisionit hetimor në një seancë të veçantë brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij. Konferenca e Kryetarëve përcakton datën e votimit në Kuvend të kërkesës për shkarkim të Presidentit të Republikës dhe kohën e debatit, sipas nenit 48 të kësaj Rregulloreje. Në rast se kërkohet nga Presidenti i Republikës për t'u dëgjuar në seancë plenare, Kuvendi është i detyruar ta dëgjojë atë. Kuvendi vendos për shkarkimin e Presidentit të Republikës me jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij dhe me votim të fshehtë. Vendimi i Kuvendit për shkarkimin e Presidentit të Republikës i dërgohet Gjykatës Kushtetuese nga Kryetari i Kuvendit brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

5. Në rast se kërkohet shpallja e pamundësisë për të ushtruar detyrën e Presidentit të Republikës, komisioni hetimor cakton jo më pak se 5 mjekë, specialistë në fushën përkatëse mjekësore, për t'u shprehur për gjendjen shëndetësore të Presidentit të Republikës. Kuvendi, me dy të tretat e të gjithë anëtarëve, vendos dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila vërteton përfundimisht

faktin e pamundësisë. Në rast të vërtetimit të pamundësisë, vendi i Presidentit mbetet vakant dhe zgjedhja e Presidentit të ri fillon brenda 10 ditëve nga data e vërtetimit të pamundësisë.

Neni 113

Shkarkimi i Kryeministrit

Shkarkimi i Kryeministrit bëhet nga Kuvendi, sipas neneve 104 dhe 105 të Kushtetutës dhe neneve 100 dhe 101 të kësaj Rregulloreje.

Neni 114

(Ndryshuar pika 3, me vendimin nr. 15, datë 27.12.2005)

Shkarkimi i anëtarëve të organeve kushtetuese

1. Kërkesa për shkarkimin e anëtarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë i paraqitet Kryetarit të Kuvendit me shkrim dhe në mënyrë të motivuar e konkrete për shkaqet e parashikuara në Kushtetutë dhe nga jo më pak se 28 deputetë, me përjashtim të rasteve kur nuk është parashikuar ndryshe në Kushtetutë ose në ligj. Me paraqitjen e kërkesës, Kryetari i Kuvendit vë menjëherë në dijeni Kuvendin dhe anëtarin e organit kushtetues për të cilin kërkohet shkarkimi.
2. Kryetari i Kuvendit ia përcjell kërkesën me dokumentet shoqëruese të saj Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, i cili brenda 15 ditëve i paraqet Kuvendit raportin dhe propozimin e tij për ngritjen ose mosngritjen e një komisioni hetimor. Në rast se personi për të cilin kërkohet shkarkimi dëshiron të shprehet në Komision, Komisioni është i detyruar ta dëgjojë atë, duke i lënë një kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe dhënien e sqarimeve. Kuvendi zhvillon debat në seancë plenare jo më vonë se 7 ditë nga data e paraqitjes së raportit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën

Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe në përputhje me kohën e përcaktuar nga Konferenca e Kryetarëve, sipas nenit 48 të kësaj Rregulloreje. Në rast se Kuvendi rrëzon nëpërmjet votimit raportin dhe propozimin e paraqitur nga ky Komision, procedura për shkarkimin e anëtarit të organit kushtetues ndërpritet. Kuvendi për të njëjtin motiv nuk mund të vendosë përsëri edhe nëse kërkesa paraqitet nga një grup tjetër deputetësh. Në rast se Kuvendi pranon nëpërmjet votimit raportin dhe propozimin e Komisionit, ngre brenda 2 ditëve një komision hetimor për këtë çështje. Komisioni hetimor është i detyruar të thërrasë dhe të dëgjojë mendimin e anëtarit të organit kushtetues, për të cilin kërkohet shkarkimi në lidhje me propozimin e paraqitur. Në rast se kërkohet shkarkimi i anëtarit të organit kushtetues për paaftësi mendore ose fizike, komisioni hetimor cakton jo më pak se 5 mjekë, specialistë në fushën përkatëse mjekësore, për t'u shprehur për gjendjen shëndetësore të personit. Në përfundim të hetimit, komisioni hetimor duhet t'i paraqesë Kuvendit në mënyrë të arsyetuar nëse ekzistojnë ose nuk ekzistojnë shkaqet për shkarkimin e anëtarit të organit kushtetues.

3. Kuvendi shqyrton me debat dhe voton raportin e Komisionit Hetimor në një seancë të veçantë brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij.

Konferenca e Kryetarëve përcakton datën e debatit dhe të votimit në Kuvend të raportit, në të cilin kërkohet shkarkimi i anëtarit të organit kushtetues, si dhe kohën e debatit, sipas nenit 48 të kësaj Rregulloreje.

Në rast se anëtari i organit kushtetues, për të cilin kërkohet shkarkimi, kërkon të dëgjohej në seancë plenare, Kuvendi është i detyruar ta dëgjojë atë.

Raporti i Komisionit Hetimor, që i propozon Kuvendit shkarkimin e anëtarit të organit kushtetues, miratohet nga Kuvendi me shumicën e parashikuar rast pas rasti në Kushtetutë.

Kur raporti për shkarkimin e anëtarit të organit kushtetues nuk merr numrin e kërkuar të votave, ai quhet i rrëzuar.

Për ato raste që parashikohen në Kushtetutë, vendimi i Kuvendit për miratimin e raportit të shkarkimit të anëtarit të organit kushtetues i dërgohet brenda 5 ditëve, sipas rastit, Gjykatës Kushtetuese ose Presidentit të Republikës.

4. Kërkesa për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit paraqitet sipas pikës 1 të këtij neni dhe shqyrtohet nga Këshilli për Legjislacionin, i cili paraqet raportin përkatës në seancë plenare. Në rast se kërkohet, Këshilli për Legjislacionin dhe Kuvendi në seancë plenare janë të detyruar të dëgjojnë Kryetarin e Kuvendit. Në këtë rast seanca plenare drejtohet nga Zëvendëskryetari që i përket shumicës parlamentare.

Neni 115

Shkarkimi i anëtarëve të organeve të krijuara me ligj

1. Kërkesa për shkarkimin e anëtarëve të organeve të krijuara me ligj i paraqitet Kryetarit të Kuvendit me shkrim dhe në mënyrë të motivuar e konkrete për shkaqet e parashikuara në ligj.

2. Kryetari i Kuvendit ia përcjell kërkesën, së bashku me dokumentacionin shoqërues, komisionit të përhershëm përkatës, i cili duhet të paraqesë një raport për seancën plenare brenda 4 javëve nga data e marrjes së kërkesës.

3. Shqyrtimi i çështjes në komision kryhet nëpërmjet një procedure që i garanton personit, që kërkohet të shkarkohet, të drejtën për t'u informuar në kohë, për t'u pyetur, për t'u dëgjuar dhe për të bërë pyetje ndaj kërkuesve të shkarkimit dhe për të paraqitur shpjegimet e tij.

4. Konferenca e Kryetarëve përcakton datën e votimit në Kuvend të kërkesës për shkarkim dhe, në rast se kërkohet nga një kryetar grupi parlamentar, edhe kohën e debatit, sipas nenit 48 të kësaj Rregulloreje, e cila në çdo rast duhet të jetë jo më vonë se 3 javë nga paraqitja e raportit të komisionit. Në rast se kërkohet nga vetë personi, nga 7 deputetë ose nga kryetari i një grupi parlamentar,

personit, ndaj të cilit kërkohet shkarkimi, i jepet fjala në seancë plenare jo më shumë se 15 minuta.

PJESA E GJASHTË INTERPRETIMI E NDRYSHIMI I RREGULLORES DHE HEQJA E IMUNITETIT

Neni 116 Interpretimi i Rregullores

1. Kur ngrihen pretendime gjatë zhvillimit të seancës plenare lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje, është kompetencë e drejtuesit të seancës për të vendosur për pretendimin e ngritur, vendim i cili nuk është objekt diskutimi.
2. Kur ngrihen pretendime për interpretimin dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje gjatë zhvillimit të mbledhjeve të komisioneve, kryetari i komisionit vendos për pretendimin e ngritur, vendim i cili nuk është objekt diskutimi. Me kërkesë të deputetit të interesuar, kërkesa mund t'i paraqitet Këshillit për Rregulloren, Imunitetin dhe Mandatet, i cili duhet të bëjë, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës, interpretimin përfundimtar për çështjen e ngritur në komision.
3. Për rastet e tjera është kompetencë e Këshillit për Rregulloren, Imunitetin dhe Mandatet për të bërë interpretimin e neneve të kësaj Rregulloreje. Kërkesa për interpretim nga ky Këshill mund të bëhet nga çdo deputet.
4. Kryetari i Kuvendit, një kryetar grupi parlamentar, një komision i përhershëm ose 10 deputetë mund të kërkojnë që çështja e interpretimit për një rast të veçantë t'i paraqitet Kuvendit në seancë plenare për të marrë vendim.

Neni 117

Ndryshimi i Rregullores

Çdo deputet ka të drejtë të paraqesë propozime për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit. Për shqyrtimin e këtyre propozimeve ndiqet procedura e parashikuar në këtë Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e projektligjeve. Ndryshimet në këtë Rregullore miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Neni 118

Heqja e imunitetit të deputetit

(shtuar pika 1/1 dhe ndryshuar pika 1 dhe pika 4 me vendimin e Kuvendit nr. 88, datë 24.2.2011)

1/1. Heqja e imunitetit bëhet nëpërmjet kufizimit të tij për vepra penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv, sipas Kodit Penal, në përputhje me vendimin përkatës të Kuvendit ose nëpërmjet heqjes së tij (autorizim për fillimin e ndjekjes penale), sipas kushteve dhe procedurave në këtë nen për të gjitha veprat penale. Vendimi i Kuvendit për kufizimin e imunitetit është pjesë përbërëse e Rregullores si aneksi 1 i saj.

1. Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese për dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit i paraqiten Kryetarit të Kuvendit nga Prokurori i Përgjithshëm. Kryetari ia dërgon kërkesën dhe dokumentet shoqëruese menjëherë për shqyrtim Këshillit për Rregulloren, Imunitetin dhe Mandatet dhe vë në dijeni deputetin.

2. Deputeti, për të cilin kërkohet dhënia e autorizimit, lajmërohet për kërkesën e bërë dhe dokumentet që e shoqërojnë atë, si dhe i bëhet e ditur koha në të cilën Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin do të fillojë shqyrtimin e kërkesës. Deputeti ka të drejtë të paraqesë në Këshill, me shkrim ose me gojë, shpjegimet dhe vërejtjet e tij rreth çështjes.

3. Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli, brenda 4 javëve, harton një raport për në seancë plenare, në të cilin rekomandon rrëzimin ose miratimin e dhënies së autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit. Raporti i Këshillit u shpërndahet deputetëve.

4. Shqyrtimi i kërkesës për dhënie e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ose arrestimin e një deputeti vendoset si pikë e parë e rendit të ditës të seancës pasardhëse, pas paraqitjes së raportit të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Në seancë plenare fjala i jepet në fillim deputetit, ndaj të cilit është paraqitur kërkesa, për të dhënë shpjegime ose për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve. Raporti i Këshillit nuk është objekt diskutimi. Kuvendi vendos me votim të fshehtë nëse do të jepet ose do të rrëzohet dhënia e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit.

5. Procedura e parashikuar në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni zbatohet edhe në rastin kur kërkohet autorizimi për arrestimin e një deputeti.

6. Në rastin kur Kuvendi nuk merr vendim për dhënie ose mosdhënie e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ose të arrestimit të një deputeti brenda 3 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës përkatëse, atëherë kërkesa konsiderohet e rrëzuar nga Kuvendi.

7. Përcaktimet e bëra në këtë nen zbatohen edhe në rastet e dhënies së autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ose për dhënie e autorizimit për arrestimin e anëtarit të Këshillit të Ministrave.

Neni 119

Procedura në rastin kur deputeti është ndaluar ose arrestuar

1. Në rastin kur një deputet është ndaluar ose arrestuar pa autorizim në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë, Prokurori i Përgjithshëm vë menjëherë në dijeni Kryetarin e Kuvendit.

2. Kryetari i Kuvendit thërret menjëherë Këshillin për Rregulloren, Imunitetin dhe Mandatet, i paraqet dokumentet e përcjella nga Prokurori i Përgjithshëm dhe i kërkon të shqyrtojë çështjen.

3. Këshilli, brenda 2 ditëve nga njoftimi i Kryetarit të Kuvendit, shqyrton nëse ka vend për procedim ndaj deputetit të arrestuar ose të ndaluar, duke dëgjuar Prokurorin e Përgjithshëm dhe deputetin e ndaluar ose të arrestuar.

4. Këshilli paraqet raportin për seancën plenare të Kuvendit, e cila thirret nga Kryetari i Kuvendit brenda 2 ditëve nga paraqitja e raportit. Kuvendi me votim të fshehtë duhet të vendosë për heqjen ose mosheqjen e masës së ndalimit ose të arrestimit të deputetit.

PJESA E SHTATË SHËRBIMET E KUVENDIT

Neni 120

Shërbimet e Kuvendit

(Shtuar pika c/1 me vendimin nr. 41/2013)

1. Shërbimet e Kuvendit kryejnë detyra këshillimore, informuese organizative dhe teknike në shërbim të veprimtarisë së deputetëve, Kuvendit dhe organeve të tij. Shërbimet e Kuvendit krijojnë mundësi dhe kushte të barabarta që deputetët, Kuvendi dhe organet e tij të kryejnë detyrat kushtetuese dhe ligjore.

2. Shërbimet e Kuvendit përbëhen nga:

a) shërbimet legislative, në përbërje të të cilave janë shërbimi i seancës plenare, shërbimi juridik, shërbimi i analizës dhe mbikëqyrjes së zbatimit të Buxhetit të Shtetit dhe shërbimi i komisioneve të Kuvendit;

b) shërbimet e informacionit dhe dokumentacionit, në përbërje të të cilave janë shërbimi i kërkimit shkencor, bibliotekës dhe arkivit, shërbimi i teknologjisë së informacionit, shërbimi i botimeve parlamentare dhe shërbimi i marrëdhënieve me publikun;

c) shërbimi i marrëdhënieve me jashtë, në përbërje të të cilit janë shërbimi i marrëdhënieve ndërkombëtare, shërbimi i marrëdhënieve konsullore dhe i trajtimit protokollar dhe shërbimi i përkthimit;

c/1) shërbimi i monitorimit të institucioneve të pavarura, që raportojnë dhe informojnë Kuvendin, monitoron veprimtarinë e këtyre institucioneve, raportet vjetore, buxhetin e tyre, me qëllim dhënien e informacionit tekniko-ligjor organeve të Kuvendit;

ç) shërbimet administrative, në përbërje të të cilave janë shërbimi i trajtimit të deputetëve, shërbimi i burimeve njerëzore, shërbimi i financës dhe buxhetit, shërbimi i transportit dhe shërbimi i mirëmbajtjes.

Neni 121

Drejtimi i shërbimeve të Kuvendit

1. Shërbimet e Kuvendit drejtohen dhe përgjigjen para Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, i cili është nëpunësi më i lartë civil në Kuvend që emërohet nga Byroja e Kuvendit, sipas nenit 11 pika 6 të kësaj Rregulloreje.

2. Sekretari i Përgjithshëm siguron dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punëve në Kuvend dhe përgjigjet para Kryetarit të Kuvendit dhe Byrosë së Kuvendit. Sekretari i Përgjithshëm përgjigjet për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të Kuvendit.

3. Sekretariatet e Kuvendit mbikëqyrin punën e shërbimeve për përmbushjen e detyrave të tyre në funksion të veprimtarisë së Kuvendit dhe të organeve të tij.

4. Struktura e detajuar dhe kufiri organik i punonjësve të Kuvendit vendoset nga Byroja e Kuvendit, me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 122

Shërbimi i Sigurisë në Kuvend

1. Për të siguruar rendin dhe qetësinë në të gjitha mjediset e Kuvendit, funksionon Shërbimi i Sigurisë në Kuvend. Shërbimi i Sigurisë në mjediset e Kuvendit është i armatosur, ndërsa në sallën e zhvillimit të seancave plenare është i paarmatosur. Shërbimi pajiset me uniformë të veçantë dhe mjete teknike për plotësimin e detyrave të tij.
2. Punonjësit e Shërbimit të Sigurisë në Kuvend veprojnë në sallën e seancave plenare të Kuvendit vetëm me urdhër të Kryetarit ose të drejtuesit të seancës dhe jashtë sallës së seancës plenare, sipas rregullave të përcaktuara nga Byroja e Kuvendit.
3. Shërbimi i Sigurisë në Kuvend për anën administrative, financiare dhe të përgatitjes profesionale bën pjesë në Gardën e Republikës.

Rregullorja e Kuvendit, miratuar me vendimin nr. 166, datë 16.12.2004

Ndryshuar me vendimin nr. 15, datë 27.12.2005

Ndryshuar me vendimin nr. 193, datë 7.7.2008

Ndryshuar me vendimin nr. 21, datë 04.03.2010

Ndryshuar me vendimin nr. 41, date 24.6.2010

Ndryshuar me vendimin nr. 88, date 24.2.2011

Ndryshuar me vendimin nr. 41/2013

ANEKSI 1



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

V E N D I M
Nr. 89, datë 24.2.2011

**PËR KUFIZIMIN E IMUNITETIT TË DEPUTETIT DHE
KUSHTET
PËR AUTORIZIMIN E NDJEKJES PENALE**

Në mbështetje të nenit 75 pika 2 të Kushtetutës, si dhe të nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

**K U V E N D I
I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Kufizimi i imunitetit të deputetëve

1. Miratohet kufizimi i imunitetit të deputetëve për fillimin e ndjekjes penale për veprat penale që lidhen me korrupsionin aktiv dhe pasiv, sipas dispozitave të Kodit Penal.

2. Për këto vepra penale kufizimi i imunitetit të deputetit bëhet për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit, për ata deputetë që deklarojnë me shkrim pëlqimin për kufizimin e imunitetit. Pëlqimi me shkrim depozitohet te Kryetari i Kuvendit dhe është i vlefshëm

deri në përfundimin e legjislaturës, me përjashtim të rastit kur deputeti deklaron me shkrim tërheqjen e saj.

Neni 2

Masat dhe veprimet procedurale që nuk lejohen

Kufizimi i imunitetit, sipas nenit 1 të këtij vendimi, ka vlerën e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale, por nuk i shtrin efektet mbi masat dhe veprimet procedurale të mëposhtme:

- a) masat shtrënguese që shkaktojnë kufizim të lirisë së lëvizjes;
- b) kontrollin e personit;
- c) kontrollin e banesës ose të zyrës së deputetit;
- ç) këqyrjen e personit;
- d) masën e arrestit.

Neni 3

Afati dhe procedurat e fillimit të ndjekjes penale

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, fillimi i ndjekjes penale për veprat penale të përcaktuara në nenin 1 të këtij vendimi, për të cilat është vendosur kufizimi i imunitetit, mund të bëhet jo më herët se 24 orë pasi Kryetari i Kuvendit dhe deputeti që është subjekt i ndjekjes penale (kur qëllimi i ndjekjes penale e lejon), kanë marrë njoftimin me shkrim nga Prokurori i Përgjithshëm.

2. Kryetari i Kuvendit, brenda 48 orëve nga marrja e njoftimit, vë në dijeni dhe i dërgon njoftimin dhe materialet shoqëruese Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin dhe njofton Kuvendin në seancën plenare më të parë.

Neni 4

Heqja e imunitetit

Në të gjitha rastet kur nevojat e hetimit dhe të ndjekjes penale nuk mbulohen nga kufizimi i imunitetit, sipas nenit 1 të këtij

vendimi, ose kur deputeti nuk dorëzon ose tërheq pëlqimin me shkrim, atëherë Kuvendi vendos heqjen e imunitetit, sipas nenit 118 të Rregullores së Kuvendit.

Neni 5 **Statusi i vendimit**

Ky vendim bëhet pjesë e Rregullores së Kuvendit si aneksi 1 i saj dhe është i hapur për nënshkrime nga deputetët gjatë gjithë legjislaturës.

Neni 6 **Zbatimi nga legjislatura aktuale**

1. Për legjislaturën aktuale deputetët depozitojnë te Kryetari i Kuvendit pëlqimin me shkrim për kufizimin e imunitetit, sipas nenit 1 të këtij vendimi, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Lista e deputetëve bëhet publike dhe i dërgohet së bashku me një kopje të vendimit Prokurorit të Përgjithshëm.

3. Çdo ndryshim i mëvonshëm i kësaj liste, nëpërmjet dhënies së pëlqimit me shkrim për deputetët që nuk e kanë bërë atë ose tërheqjes së deklaratës, depozitohet te Kryetari i Kuvendit, bëhet publik dhe i njoftohet menjëherë Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 7 **Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKLARATË

Unë deputeti _____ deklaroj kufizimin e imunitetit tim për veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv sipas Kodit Penal.

Ky deklaram bëhet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit dhe të aneksit 1 të saj.

DEPUTETI

Tiranë, më _____